ExLibris

E PËRJAVSHME
LETRARE
KULTURORE
çdo të shtunë
Themelues • Kryeredaktor
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 18 JANAR 2020. NUMËR 62. VITI II I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

45 vjet më parë, më 15 janar 1975, u nda nga jeta shkrimtari, poeti, përkthyesi dhe studiuesi i shquar i letërsisë shqipe

ERNEST KOLIQI

Arti i Martin Camajt



Portreti nga Ina Lajthia

Camaj, tashmâ, ka nji emën mirkumbues ndër shijuesa të poezís shqiptare. Me veprat e derisotshëme na ka bindë se u pajis nga natyra me nji talent të hollë e njiherit të fuqishëm. Ai fillon parabolen e vet ashtu e aty ku shum tjerë deshirojnë me sosë mbas nji jete kalue n'ethe të përpjekjeve në lamë të letresís. Dukagjini, – ky vis ku u ruejten të paprekuna doket e burrnija stërgjyshore dhe ku banorët mund të njehen mâ tepër se ngjeti tepricë katallâjsh ilirjanë kursye nga stuhija zvetnuese e kavaljetave, – Dukagjini, thom, tekembrâmja gjeti mjetin shprehës.

(fq. 2)

Parulla e modës: "LIBRI NË DEKADËN E RE"

nga Xhevair Lleshi
shkrimtar, botues

Nuk më hiqet nga mendja as titulli, as kërkesa: *Libri në dekadën e re*. Ministria e kulturës i ftoi të gjithë ata që mund të jepnin një dorë për kujdesin ndaj librit. Unë nuk mora dot pjesë në takim, por do t'i jap mendimet e mia sipas pikave të referencës së *parullës* dhe, po qe se ministria e lexon gazetën, le t'i shohë ato me vëmendjen e duhur.

Shtegtimet lirike në poezinë e Elida Buçpapajt

Prof. Dr. Eshref Ymeri (fq. 4)

TIRONA O E NONËS. PO KRYEQYTETI KUJT I PËRKET?

nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

Libri i fundit i Fevziut, "Tirona e Nonës", në tërësinë e tij: i shkruar bukur, me një intensitet emocional që përcillet në kohë reale, me një aftësi të admirueshme në portretizimin e protagonistëve të rrëfimeve...

(fq. 12)



PARATHËNIE PËR ENCIKLOPEDINË "SHQIPTARËT NË ARTIN BOTËROR" TË PROF. FERID HUDHRIT

Komunikim fisnik midis popujve nëpërmjet pikturës

Nga **ISMAIL KADARE**

(fq. 6)

PËR OSCAR WILDE-IN DHE PLAGJIARIZMIN

nga Joseph Bristow,
Rebecca N. Mitchell

(fq. 9)

PËRBINDËSHI I RRUMBULLAKËT

tregim nga
Alberto Moravia

GJAKU I HËNËS

poezi nga
Shazim Mehmeti

'Meshkujt janë kudo': Svetlana Alexievich do të themelojë një shtëpi botuese për shkrimtaret femra

nga Paula Erizanu (fq. 9)

45 vjet më parë, 15 janar 1975, u nda nga jeta Ernest Koliqi shkrimtar, poet, përkthyes dhe studiues i shquar i letërsisë shqipe

ERNEST KOLIQI

Arti i Martin Camajt

Camaj, tashmâ, ka nji emën mirkumbues ndër shijuesa të poezís shqiptare. Me veprat e derisotshëme na ka bindë se u pajis nga natyra me nji talent të hollë e njiherit të fuqishëm. Ai fillon parabolen e vet ashtu e aty ku shum tjerë deshirojnë me sosë mbas nji jete kalue n'ethe të përpjekjeve në lamë të letresís. Dukagjini, – ky vis ku u ruejten të paprekuna doket e burrnija stërgjyshore dhe ku banorët mund të njehen mâ tepër se ngjeti tepricë katallâjsh ilirjanë kursye nga stuhija zvetnuese e kavaljetave, – Dukagjini, thom, tekembrâmja gjeti mjetin shprehës. Grumbulli i ndiesive, ndrydhë ndër mote, nëpër këtë mjet po vjen tue u shfaqë. Nji tjetër zâ lartushtues doli nga Dukagjini: zâni i paharrueshëm i At Bernardin Palajt. Anmiqt e emnit shqiptar e shuen, në vuejtje e në gjak. Ka, veç, nji ndryshim ndermjet dy auktorve dukagjinas: Palaj, i ndrým në nji përftim epik të jetës dhe i rrembyem n'andrrime të madhnueshme qi kishin rrâjën në lavdít e kalueme të kombit, nuk prekej nga shartet e sotshëme të burrave të malsís: ai shifte, nën tirqit e mitanat e shkyem të tyne, madhështín e legjonarve, të cilët, të prîm nga perandori ilir Konstantini, thyen krenín rromake të Maksencit, tue shpague gjakun e bijve të fisit të rám flîje Vendireve e të lojnave pagane në Kolosé. Në vjerrshat e tija (mjerisht pak ase aspak të njoftuna) ai ndiellte përtrîmjen e nji kohe vigâjsh për Shqipní, në nji periudhë të historís së botës dhe të vendit tonë kur çdo rreze epike po shkimej tue u xevendsue nga të mugëtit e egoizmave mâ mizore, si t'individeve ashtu të kombeve. Andrra e nji Shqipnije së madhe, qi tepër vrap flakoi dhe u zhduk në kaltherí të malbrezeve tona, ia deji menden, ia lumnoi për nji ças shpirtin. Mbas pak kohe, edhe ai mbaroi tue marrë me vete në vorr trashigimin e Fishtës, sepse ai qe i vetmi ndër né qi prej lahutës brîdashe dinte e mujte të nxjerri kumbime, nëpër të cilat thjeshtësija skalitëse e shprehjeve rapsodike shqiptare shoqnohej e depertohej nga nji harmoní e thellë symfoniare me të kujtue fuqín e gjânë të muzikës së Wagner-it.

Tjetër tingull ká si poezija ashtu proza e Camajt. Pámjet e ndryshme të jetës së vendit të vet dalin nepër art të tij të vizatueme me drita e me hije dridhëse. Atij, edhe padeshtas, i shkon syni ke brumi njerzuer. N'ato vigâj të rrzuem, ai kerkon njerín. Lufta qi malsori ndërmerr për me dalë nga gurzimi i nji gjendjeje shoqnore kurrkund në pajtim me kohën e sotshëme, ia thekë shpirtin. Ai s'don qi burri i malsís të shikohet si specimen i nji rrace së lashtë, objekt kureshti per t'u vendue në nji muzé. Nën leskrat xhixhilluese të nji epiciteti anakronistik, syni vezhgues i tij kundron me zêmër të plasun rrudhat e shkaktueme nga ûja, nga mundi keq i shpërblyem prej natyrës e njerzve e fatit, nga ndryshku i disa zakoneve dâmprûse, nga ngushtësija e vendit. Në veprën e parë (Nji fyell ndër male, Shtëpija Botuese «Mustafa Bakija» Prishtinë, 1953) Camaj i çekë këto çâshtje. Fatlumsisht mjerimet e vendit të vet zhyten në valën e kulluet të nji lirizmi plot hov të vetvetíshëm. Menjiherë, qyshë në hapat fillestarë, ndiehet n'art të këtij auktori të rí kundërshtimi (kontrasti) ndermjet nji kulture të vetedijshme (konshjente) dhe të primitivitetit rrjedhë nga lindja. Studimet themelore klasike shkundin, në lumnín rrjedhëse të vjerrshës së tij, pluhnin libresk dhe përvoesohen me mrekullín e freskët të ligjirimit të malsorve. Parafytyrimet kanë nji xhixhillim bukurije së çuditshme në nji artist fillestar. Mâ e mendueme paraqitet landa e librit të dytë (Kanga e vërrinit, Prishtinë, 1954). Edhe titulli tregon kalimin nga fryma e breshtë plot hov krijues e malit në klimën mâ të butë të fushës. Por malet hjedhin hijen e vet edhe mbi fushë. Nji shqetësim i pacaktuem shpirtnuer qarkullon në mbrendí të këtyne vjerrshave. Dishiri për jetën e thjeshtë të malsís rîn me lot të msheftë disa prej tyne, nji ndiesí e mblueme malli për zakonet fisnike, qi lëvitë aty këtu, zbutë premín e dënimeve qi vende vende shqipton kundra tyne, nji gjakim m'u zgjâ me përvojë të vet në nji botë mâ të madhe digjet prej vargut në varg.

Trajta në librin e dytë shënon nji përparim të papritun. Jo mâ rrjedhja e lirë e njimbëdhetërrokshit kumbuer ase e vargjeve tjera me tubza përgjithsisht të rregullta. Nji zhdërvjelltí mâ e madhe shifet në ndertim të vargut dhe nji perkim mâ i perpikët ndermjet të theksuemit rythmik dhe permbajtjes. Hove hove shprehja poetike qi lëshohet gzueshem e përmallshëm në nji rrymbë të gjânë e të ndêjshme, e cila ta dhelaton veshin e derdhet âmbël në shpirt, befas ngurron, si e turitun, thehet e acarohet tue jehue me gjasërame të vrashta. Janë synkopet e artit modern. Camaj ndermjet veprës së parë e të dytë, ka lexue shum në gjuhë të hueja dhe ka diktue nji afersí të ndieshmenís (sensibilitet) së vet me auktorë të pararojes letrare të prendimit. Ka përvetësue mjetet mjeshtrore të tyne për me hollue artin e vet. Edhe âsht për t'u mrekullue s'pari dhe mandej për t'u gzue, tue pasun para sŷsh pasunimin motivesh e trajtash të letresís sonë, për mënyrën se si ky pinjuell malesh, sigurisht i pari i sojit të tij qi xên me shkrue e me këndue, din të harmonizoje në shkrime primitivitetin ruejtë në plotsín mâ të plléshme me nji zotnim të mjeteve mâ të rafinueme t'artit letrar modern. Ky harmonizim i rrallë âsht nota dalluese e disa shkrimtarve të rij të Kosovës e të Shqipnís së vjetër. N'asnjanin, veç, prej tyne nuk tingullon ende në mënyrë aqë të spikatun si ke Camaj, i cili qyshë tash mund të njehet përtrîsi i nji rrymbe së ré në letrat shqiptare, rrymbë e shqueme prej nji çveshjeje nga çdo zbunim retorik e për nji prirje me zbulue në vetvete e në tjerë vetít mâ të strukuna në skuta të vetedijes dhe n'errsít e mystershëme të nênvetedijes.

* * *

Por të vijmë ke vepra qi kam nderin me ua parashtrue lexuesave të njerzishëm, ke «Djella».

Rromanx apo dituer poetik? Çanësimet e veprave vërtè origjinale janë përherë të vishtira. Auktori, pa u kujdesue për gjinít letrare dhe tue lânë mbas dore mësimet e marruna në shkollë, e derdh landën në nji kallep sui generis. Kjo tregon se, i rrembyem prej diçkahit të përmbrêndëshem qi don të shpërtheje jashtë, kalon sipër modeleve të zakonshme edhe i shtjellon mendimet e ndiesít në trajtën mâ t'udobët dhe të vetvetishme. Nuk lodhë menden për teknikë tregimtare. Argumenti i vlon në shpírt dhe lirohet prej tij tue perdorë herë prozën herë vargun. Natyrisht edhe proza, shpesh, ndiehet se âsht mbarrsue me poezí. Por, tue e shqyrtue imët tekstin, vrehet se në prozë ai paraqet përshkrimet veriste me nji çilterí guximtare dhe shfaqë mbresa e gjikime të mprehta dhe heraherë të përshkueme nga nji dell pesimizmi, mandej në vjerrshë ep nji synthezë lyrike, ku shfren e fisnikohet idhnija e zêmres së turbullueme. Vargjet janë si ushtima e âmbëlsueme e ngjarjeve disi të zymta qi përbâjnë t'endëmen e tregimit.

Filli kryesuer i kësaj vepre synon me paraqitë zbritjen e malsorve nga malet e lindjes në fushë, për të kerkue nji permirsim shoqnuer. Drami i dyndjes pikzohet me ngjyra të gjalla. Breznija e parë – qi lên votrat e nalta e vetmitare, ku njeriu rritet nji cope i shëndoshtë në trup nëpër fllade të kullueta e i shëndoshtë në shpírt në ngursín e dokeve qi prap se prap ruejnë tharme bujare nën mbulojë të mykun, e dirgjet në jallín plot helm moçalesh banue nga nji njerzí mâ e zhvillueme shoqarisht, – kalon nëpër prova të trazueshme e shpesh të rrezikshëme. Bardh Qerreti, mësues e shkrimtar, me xânafillë prej malesh, ka mbetë shpirtnisht ndër domna. Bjerrë hovin veprues qi malsori ka në gjak, valavitet në ndiesí të dyshimta. E don ase e lakmon Djellen, katundaren e hijeshme, por i mungon guximi me ia hŷ pushtimit të saj. Ia lëshon shtegun Currit, malsorit të pagëdhênun, i cili në thjeshtësín e vet din shka don, trimnisht ndjek prirjet e instinktit dhe bân për vete Djellën. E bukura e katundit bjen, si pré e fitueme në luftim, në dorë të malsorit qi shfaqë pa zhibla dishirin e vet epshuer. Vuen nga kjo humbje mësuesi vjerrshatar? As ai s'e din: ia kande katundaren e ré për disa cilsína fyzike të saj, cilsína qi ai ia ngjeshë nji krijatyre së sendërgjueme prej mendes së shqetë të tij. Zbritja në qytet, shkolla, leximet Bardhit ia kanë këputë zêmrekun e vullnetit, tue e plandosun në nji gjendje të mugët shpirtnore, por n'anë tjetër i kanë dhurue ândjen e andrrimit. Fuqija vepruese e malsorit në tê, tue u shkimë, i ka lëshue vend valavitjeve të holla e dejse të soditjes. Jeton, në vetmí të katundit, me vegime të fantazís. Asht nji hap kah qytetnija, por i paguem shtrêjt me tronditje shpirtnore qi përpîn fatbardhësín e rëndomët dhe e mbushë me trishtime të perherëshme. I vetmi ngushllim, shfrimi në vjerrshë. Vjerrshimi, drrasë shpëtuese në tallaz kapërdís të jetës.

Portreti nga Ibrahim Kodra

As Curri nuk shpëton nga rreziqet e fushës. Ernat helmatuese të kënetës ia thithin fuqín e gjakut malsuer. Kënetë e shpirtit âsht për tê Djella. Rrëzohet si lis degmadh, të cilit ujnat grryesa te shpatit ia shêmbin dhén rreth rrâjve. Asht ulun prej lugjeve të ftofta të lindjes për me gjetë «nji vrrî pa dimën» dhe në fund nuk gjên tjetër veçse mardhën e dekës.

Nuk duhet të çuditemi për ashpërsín veriste të disa pershkrimeve, për shijen e thartë të disa ndiesive. Auktori âsht pjestar i nji djelmnije të vrugosun në shpírt nga nji stuhí ngjarjesh tepër shqetesuese, të nji djelmnije qi u randue me vuejtje të pameritueme ç'se filloi me marrë mend e shqise dhe njofti mergimin, burgimet, fushat perqendruese, punën e përdhunëshme. U rrit, kjo djelmëní, pa vokësín e ambël të votrave familjare, pa ngushullimin e nji këshilli miqsuer. Ndëgjoi vetëm ungrimat e mënís, joshjet antinjerzore të partizaníve politike, mospërfilljen e talljen e njerzve qi kanë zgjidhë çashtjet vetjake dhe kanë shtypë e shqymbë në vetvete lakmimet e mystershëme të shpirtit. Në rasën e veçantë të Camajt puthitet koha e kapërcimit të moshës së tij me periudhën ndrrojse e turbulluese historike qi u hap me krisjen e luftës së dytë botnore. Kjo epoke, edhe pse nuk âsht e caktueme në tregim, pasqyrohet e qartë në tê. Djella, para se me qenë vepër artistike qi pasunon letresín tonë, âsht nji dokument njerzuer me randësí. Camaj ep herherë pershtypjen se vên në dyshim ase perçmon vlerën njerzore të traditave të lashta, por, tue shqyrtue me vemendje fijet e ndryshme ndiesísh qi perbâjnë pelhuren e thukët të hartimit të tij, hetohet se palci i frymzimit âsht shi shpirti i urtís gojdhanore.

Pikëspari burrnija e malsorit, përshkrue në mënyrë theatrore prej dashamirve të folklorit dhe zbukurue me ngjyra pitoreske si tepricë terhjekëse e Mesjetës midis mohes athomike, në Camaj thjeshtësohet e buron si çilterí. Trimnisht përdorë penden si të parët e tij taganin dhe pushkën. Largon çdo tis retorik qi mshefë jetën e gjallë, të njimendët, lakuriqe dhe shprehet pa nazet e turpit kallp mikroborgjez. Veprës së tij, si dishmí jete shqiptare, i avitet landa, por jo trajta së cilës i mungon shkelqimi i perpunimit artistik, e veprës së çmueshme «Ç'më tha nenua» e Muzine Kokalarit.

Prova qi tregimi i undyrshëm i Camajt nuk perfundon me nji mohim të vlerave gojdhanore gjindet në disa thânje pohuese qi padashtë i rrëshqasin nga penda. Kaptina ku flet Bardhi për prindët mund të keqkuptohet. Drami i marredhanjeve t'etënve të pashkolluem me bij t'arsimuem, në pak faqe vërtè të fuqishme, âsht i shprehun në mënyrë qi skalitet në mende të lexuesit. Dy brezní maten njâna me tjetrën. I riu duket egërsisht i paevarshëm para plakut. Jeta e gjithkuj i ka këto çase ndeshjeje e kacafytjeje shpirtnore. Asgjamangut vjen koha qi malsori i qytetnuem, Bardhi, njef randësín jetësore të trashigimit shpirtnuer të parve.

Kujtimi i t'et e shtŷn me shkrue këto vargje:

«Dý gjana print më than' kur ishin gjallë:
– Poqese se shkel ti bukën gand
Çoje prej dheut e puthe e vene në báll.
Ndegjò, ti djalë, pse na jemi pleq.
Kur t'rrijsh te votra pshtet' tue pí duhan,
Mos pshtŷj në zjarm,
Mos pshtŷj' në dritë se a keq!
Kam harrue shum sende qi m'i thanë print!
Shum tjera msova e dola ndoshta i larm,
Por bijve t'mij un kam me u thanë tu'u rritë:
Mos shkelni n'bukë,
Mos pshtŷni n'zjarm,
Mos pshtŷni n'dritë!»

Vjerrshë me veshtrim shum të thellë në thjeshtësín e dukëshme të saj. Janë nji përlavdim plot afsh të ndrydhun i dokeve stërgjyshore. E kalimi i tyne në brezní t'ardhëshme premtohet me nji fuqí të ngulun (nëpërmjet parafytyrimeve symbolike) si t'ishte betim. Ka dhe mâ tepër. Fisnikija e lashtë e malsorve, kalorsija e natyrshme qi ua pajisë shpirtin, pikon papritmas edhe në vepër të këtij pinjolli të tyne, i cili din harresën e padrejtë në të cilen bota e huej dhe vendase la malet, qi ka para sŷsh mosperfilljen e paevarëshme qi shumica e qytetarve ka diftue për këto fatosa të lindun të cilët si kalá e gjallë mpruen kombin nga sulmet e Slavëve. Po, për nji ças, ngadhnjei ndoshta në tê urrejtja. Asht për t'u dënue çdo urrejtje, por kjo e malsorit të kulturuem, njohës i vuejtjeve historike të popullsís së maleve, ka shkaklehtësime të mëdhá.

Hovi burrnuer i trashiguem në gjak shlyen mendimin «se brîjat e maleve të rrëmyeta rreth lumit janë bâ mure të mënershme të nji burgu shekulluer të ngjeshuna me nji lymashk të vjetër në vend të pyjeve të blera: aty janë kalbe breznína», perdëllen shkujdesjen e vllazënve të nji gjaku qi i lanë këto brezní në terr të padijes e ndër kethetra të vobsís mësa ata gëzojshin driten e qytetnís dhe nji mirqenje të zgjedhun shoqnore. Lëshon nji kushtrim jo mâ luftarak, por paqsuer, plot shpirtbardhní dhe flakë dashunije njerzore.

«Avitu, njerí!
Nga palci i urrejtjes deshiroj me dalë
si bima prej fare në pranverë.»

Shndrrohet mënija në ndiesí vllaznore. Pasunija shpirtnore e trashigueme vlen si hajmalí kur ndokush prej maleve zbret në fushë. Tradita shpëton burrin e malsís nga zvetnimi. E kombi, ndër qytete të mkambuna kah qytetnija, përtrihet e fuqisohet nëpër mjet të gjakut dhe të frymës së shndoshtë morale të bijve të maleve.

Nuses nuk i vjen mâ turp për xânafillen e vet katundare. Këtë ndiesí shelbuese kanë me ushqye edhe nipat e malsorve të zbritun prej bjeshkve në fushë.

Me këto kriza mendore, në gjire të ndiesíve të turbullta, në valavitje epshesh t'egra e andrrimesh mahnitëse, nëpër prozë e vjerrshë shkrue me lot e me gjak të jetës, vjen tue u trajtue Shqipnija e ardhëme. Edhe e reshët Perendija me hire e me të mira!

Por në lamije t'artit, qellimet e mira ase të këqija të shkrimtarit nuk çojnë kandar. Aty vlen vetem bukurija e veprës. Djella e Camajt mundet me qenë dishmí mjaft e interesantshëme e mendesís të rijve të sotshëm, nji analyzë e randësishme e fenomenit shoqnuer të dyndjeve të popullsive, nji pikzim i vlefshëm në pikpamje ethnologjike zakonesh sot të rralla n'Europë; të gjitha këto merita nuk do t'a naltësojshin në sferen e veprave të dêja për nji dallim të posaçem në rigatë të Zânave arbnore. Ka cilsít e duhuna artistike për nji lavdurím të shenueshëm, tregimi i këtij shkrimtari të rí? Mbas mendes sonë, jo vetëm plotson sasín e cilsive qi nevojiten për m'u njehë vepër arti, por e kapërcen përtej cakut,

Me nji leksik e nji frazeologjí të zhdervjellun – me nji sigurí vizatimi tipash të ndryshëm, – me nji gjallní djalogesh qi me premín plot veshtrim të tyne zbulojnë fundet e shpirtit të vetjeve – me nji stil të rrasët e të ngjyrëshëm ku hijet e dritat ternohen me mjeshtrí të natyrëshme, – Camaj në pak faqe krijon nji botë të vogel qi vuen e gzon para sŷve tonë.

Ndërsana, katundi i Djellës, del e përshkrueme, me pak rrjeshta në menyrë të paharrueshme. E këneta zotnon me duhëm t'ajrit mbushë me helm jetën e katundit tue i përpî njerzit në gjí të vet, i cili duket i lëmuet e i butë, perkundrazi âsht i rrezikëshem pse të çon fill në krahë të Dekës. Rruga e qytetit gjarpnon dhe lëshon ftime tunduese, tue premtue andje të panjoftuna e naltësime shoqnore.

Vetjet e para të tregimit: Djellen, Currin, Bardhin qi shkruen, na duket se i kemi njoftë diku, se ua kemi ndjekë për s'afërmi nderlikimet e shpirtënve të shtrydhun prej furís së gjakimit. Auktori na thotë aqë për ta sa mjafton të na ngallisi menden me plotsue na vetë fytyrat e tyne. S'janë lânë mbas dore as vetjet e dyta: bukur skicue paraqiten Bukuroshja, qi i sherben Bardhit, malsori i ndeshun udhës prej Bardhit kur këthen në vendlindje, Shpresa vajzë qytetare e dejun me lexime rromanxash, Sosja lavire malsije.

Po vendet? Pusi e fiku pranë shtëpís së mësuesit na paraqiten si me i pasë pá na vetë me sŷ. Këthimi i Bardhit në vend t'etënve dhe rrenojat e shtëpís atnore janë fletë të lume qi nderojnë letrësín tonë.

E ushqyeme prej fatkeqsíve, prej trishtimeve të kohës, prej idhnimeve të parreshtuna, të cilat trondisin zêmrat, i mbushin me mullâj qi kerkojnë shfrim dhe nxisin trût me u dhânë dum mysterit të jetës, letrësija e jonë në kohnat e fundit âsht begatë, ndër te gjitha gjinít, me krijime të reja sidomos në deget e mbetuna mbrapa tjerave për kah zhvillimi, si ajo tregimtare ashtu ajo e artit dramatik. Dhimbat shporojnë shpirtënt, gjinikojnë dritë e lulzim si bûcat e dheut qi vetem kur parmenda i then e i çán me plorin e mprehte falin begatín e kallzave ari.

Djella e Camajt, tue iu shmângë guximtarisht çdo konvencjonalizmi shtînjarak e tue na vizatue me pendë mjeshtrore bukurít e shembtimet e nji pjese së gjallë të botës shqiptare, ka me xânë menjiherë nji vend të shquem në letresí tonë.

("Shêjzat", Romë, 1958)

Shtegtimet lirike në poezinë e Elida Buçpapajt

Prof. dr. Eshref Ymeri

Vitin e kaluar, u botua libri *"Ujshëm"* i poetes, publicistes dhe përkthyeses së talentuar Elida Buçpapaj. Libri përmban dymbëdhjetë cikle me 42 poezi dhe zë një vëllim prej 172 faqesh. Ai e pasuron më tej krijimtarinë letare të kësaj poeteje, e cila, përveç botimit të vëllimeve të mëparshme poetike, ka sjellë në gjuhën shqipe edhe përkthime të shumta nga krijimtaria e mjaft poetëve të huaj.

Ky vëllim më ra në dorë ca kohë më parë dhe kur e mbarova së lexuari para dy ditësh, më la mbresa të fuqishme për lirizmin e tij mahnitës. Madje lirizmi përbën boshtin kryesor të krejt poezive të këtij vëllimi. Problemi i lirizmit, si një fenomen estetik, dëshmon për aftësinë e autores për trajtimin e dukurive të jetës së përditshme. Përmbajtja psikologjike e përjetimeve të saj përbën themelin e lirizmit të këtij vëllimi, në të cilin ajo ka krijuar një unitet artistiko-psikologjik, duke filluar nga sistemi i figurave dhe i motiveve lirike, deri te përsosja ritmike dhe intonative. Lirizmi përbën njërën nga karakteristikat e të menduarit artistikisht të Elidës, që bazohet në përjetimet personale gjatë perceptimit të ngjarjeve në morinë e realiteteve shqiptare, çka gjen pasqyrim në gjendjen e saj shpirtërore.

Përmes lirikës poetike, Elida shpreh mallin për atdheun e dashur, prej të cilit është larguar rreth një çerek shekulli më parë dhe ëndrrat e kanë ndjekur pas orë e çast për t'u kthye në gjirin e tij. Shtegtimet e saj lirike, duke filluar që nga Amerika dhe deri te atdheu amë, janë me të vërtetë emocionuese. Në shtegtimet e saj ndihet dëshpërimi i ikanakëve, të cilët jeta i detyroi të braktisin vatrat amtare dhe të marrin arratinë drejt vendeve të huaja. Dhe fajin për këtë poetja ua vë politikanëve parazitë, në përshkrimin e të cilëve lirizmi i saj vjen e merr tiparet e një revolte patetike.

Shumë prekëse është poezia *"Refugjatët"*, të cilëve Evropa, siç shkruan poetja, *"ua mbyt anijen e shpresave"*. (Ah, Evropë, Evropë! Ndaj nesh ti ke ushyer smirë, për gjuhën tonë të shenjtë, të dëlirë, se prej saj ke marrë shumë dije, se është një gjuhë perëndie. Ndaj Plini Plaku vetë ka thënë: latini që kur është zënë, me alfabetin tonë ka nxënë. Leibnici yt dikur ka shkruar, këtu e dy shekuj të shkuar: kulturën tonë parakristiane, që ta mësojmë ne kësaj ane, na duhet shqipja kapedane. Për ne ke qenë përherë një dhelpër, ndaj kurrë nuk more pamje tjetër. T'i them këto, Evropë e mpitë, që ta kthjellosh trurin një ditë).

Në të njëjtën kohë, në poezitë *"Heshtja"*, *"Indiferencë"*, *"Populli"* etj. Elidën e kaplon një zjarr poetik për heshtjen e popullit para një grushti politikanësh, të zhveshur nga dinjiteti kombëtar dhe të zhytur në botën e aferave korruptive. Poeten e revolton heshtja e njerëzve në vendin tonë, i cili ndodhet në kushtet e një neodiktature. Kur i lexova këto poezi dhe disa të tjera për gjendjen ku është katandisur vendi ynë në atë neodiktaturë, m'u kujtuan fjalët e regjisorit rus të filmave dokumentarë *Vitali Manski (1963):*

"Putini po jeton në një realitet krejt tjetër, në një realitet "hyjnor". Dhe, për pasojë, - vazhdon regjisori, - *"pjesa dërrmuese e popullsisë ruse e përfshin atë në radhën e shenjtorëve"* (Citohet sipas: *"Ç'ka në kokë diktatori?"*. Marrë nga *"Novaja gazjeta"*. 29 qershor 2016).

Shtrohet pyetja: mos vallë edhe populli ynë, në kushtet e neodiktaturës, është duke ecur në gjurmët e popullit rus?

Lexuesin e ngre peshë poezia kushtuar Nënë Terezës, humanistes emblematike në mbarë rruzullin tokësor. Kur lexuesi njihet me përmbajtjen e kësaj poezie, mund t'i shtrojë vetes pyetjen:

"Perëndimi evropian vallë a e ka vrarë mendjen ndonjëherë se si shpjegohet që pikërisht Skënderbeu dhe Nënë Tereza kanë dalë nga radhët e etnosit shqiptar?".

Sigurisht që nuk e ka vrarë kurrë mendjen ndonjëherë, se ndryshe, edhe për fajin tonë, nuk do të na i kishte bërë çarçaf trojet tona etnike. Personaliteti i Skënderbeut dhe i Nënë Terezës janë dëshmia më kuptimplote e fisnikërisë së kombit shqiptar, të cilin gjithmonë e ka pasë karakterizuar shpirti i madhështisë, i mishëruar gjatë shekujve në humanizmin dhe në mikpritjen proverbiale.

Lexuesit i ngjallin mallëngjim të thellë poezitë *"Kosova dashuria ime" (Kosova mon amour)* dhe *"Të du Kosovë"*. Në vargjet poetike të Elidës, Kosova lartohet mjeshtërisht, si krenaria e mbarë kombit shqiptar, si "tanku" i kreut të "kolonës" mbarëshqiptare. Por Elidën zemërndezur e ha një merak përbrenda: mos vallë edhe Kosova ka filluar të ecë në gjurmët e atdheut amë në instalimin e neodiktaturës?

Plot aromë ngrohtësie tingëllon lirizmi poetik në poezitë kushtuar mjediseve zvicerane, si "Berna", "lumi Aare", "Urat e Bernës" etj.

Në vargjet poetike të Elidës gjejnë pasqyrimin e vet pylli i heshtur në dremitjen e vet të magjishme, qielli kryelartë, deti hijerëndë, shiu jetëdhënës dhe retë endacake në bredhërimat e tyre nëpër hapësirat e përjetësisë.

Ciklin e fundit të këtij vëllimi poetik, me titull *"Nënës time"*, Elida ia kushton kujtimit të nënës së saj të dashur, *Lili Skënderit,* e cila u nda nga jeta më 08 shkurt 2016. Në ato vargje Elida ka derdhur gulshet e shpirtit të saj të brengosur, mallin përvëlues për nënën e saj të shtrenjtë, bashkëshorten e poetit të shquar lirik Vehbi Skënderi, i cili, ashtu si Mitrush Kuteli dhe Lasgush Poradeci, kurrë nuk e pati ulur kokën para diktatorit dhe diktaturës.

Në lirizmin poetik të Elidës vjen e përftohet figura e personalitetit të saj, të ravijëzuar edhe psikologjikisht, edhe emocionalisht, me reagimet përkatëse karakteristike ndaj realitetit mjedisor dhe ngjarjeve të përjetuara. Poezia e kësaj poeteje me një personalitet të konsoliduar intelektual, dëshmon për shkallën e formimit të saj kulturor. Ajo është mjeshtre e gdhendjes së fjalës poetike. Puna profesionale me fjalën poetike nuk është një zeje e arrirë për të gjithë poetët, por sidoqoftë janë pikërisht ata që e mbajnë të ndezur zjarrin e përjetshëm të poezisë. Talenti i Elidës qëndron në pasqyrimin e realitetit me vërtetësi artistike.

Poeti mund të jetë edhe doktor i shpirtit njerëzor, edhe mësues i jetës, edhe piktor, instrumente të të cilit janë jo ngjyrat e tablosë, por aftësia për ndërtimin e rimave. Poezitë e Elidës dëshmojnë më së miri se ajo është një mjeshtre me shije të hollë në strukturimin e vargjeve të tyre. Poeti i shquar rus *Aleksandër Bllok (1880-1921)* ka thënë:

"Ç'është poeti? Një njeri që hedh në letër vargje? Natyrisht që jo. Ai quhet poet jo se hedh në letër vargje. Por sepse kur hedh në letër vargje, do të thotë se ai sjell në harmoni fjalët me tingujt, sepse ai është bir i harmonisë, është poet".

Dhe me të vërtetë: në lirizmin poetik të Elidës, në këndvështrimin tim, nuk janë rimat ato që përbëjnë veçorinë kryesore të poezisë së saj, por është thellësia, saktësia dhe përmasa e riprodhimit të gjithçkaje që ajo percepton në jetën e ditëve tona.

Santa Barbara, Kaliforni
10 janar 2020

PARULLA E MODËS: “LIBRI NË DEKADËN E RE”

Nga **Xhevair Lleshi**, shkrimtar, botues

Nuk më hiqet nga mendja as titulli, as kërkesa: *Libri në dekadën e re*. Ministria e kulturës i ftoi të gjithë ata që mund të jepnin një dorë për kujdesin ndaj librit. Unë nuk mora dot pjesë në takim, por do t’i jap mendimet e mia sipas pikave të referencës së *parullës* dhe, po qe se ministria e lexon gazetën, le t’i shohë ato me vëmendjen e duhur.

Politikat e Ministrisë së Kulturës për librin në këtë dekadë të re sfidash...

Nuk i dëgjova dot *politikat* që ka deklaruar Ministria e Kulturës, por do t’më pëlqente që për këtë dekadë të re sfidash të stërpikej pa harruar asgjë punën dhe dimensionet e saj me librin. Të jepte edhe *pamundësinë për librin*, sepse qendrat e vogla bashkiake duan bibliotekat, se libri kërkon një shpërndarje të përqendruar dhe kapilare, me një rrjet që mund të përfshinte edhe PPP. Problemet e librit elektronik dhe hapësirat e tij, apo edhe çfarë mundësish krijon ministria e kulturës duke e vënë dorën në plagë. Dhe plaga e librit është goxha e madhe. Madje, nuk do ishte keq që të krijonte institucionet e duhura për bibliotekat bashkiake (61 të tilla) në të gjithë vendin. Libri vuan edhe nga një ngërç i çuditshëm, *mungesa e fondeve* të duhura dhe prania e një liste që qarkullon nën dorë si pasaportë hyrje-daljeje e librit, i cili pranohet ose dëbohet... Këto lista fantazmë që u diktohet bibliotekave është politike, e dobët dhe jashtëzakonisht e dëmshme, sepse s’ka asnjë vlerë, është shumë e vjetër dhe jashtë të gjitha përmbajtjeve që kërkon koha e sotme...

Synimi i një politike gjithëpërfshirëse në interes të librit dhe autorit shqiptar

Është një mënyrë e ngurtë të shprehuri që në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dëmton librin dhe autorin shqiptar. Sepse ne mjaftohemi me *parullën* dhe kjo si dukje quhet punë e kryer. E ku ka synim politik më të madh e më gjithëpërfshirës në interes të librit dhe të autorit shqiptar, sesa t’i kushtosh atyre vëmendjen aq të lakmuar të shtetit ndaj këtyre dy pikave të nxehta të shoqërisë së sotme shqiptare. Kjo është dëshirë të zjarrtë e librit dhe e autorit shqiptar, sepse mungesa totale e vëmendjes ndaj tyre është një arratisje e madhe nga e vërteta. Në tërësi tabloja është e zymtë, sepse bibliotekat në këtë vend të vogël e të mjerë janë joekzistente, ndërsa fol po deshe kundër tyre, trego të vërtetat dhe je i akuzuar se jo vetëm prish imazhin dhe bojërat por edhe për shpifje! Këtë gjendje të dhënë me *konçension* kanë edhe njëmbëdhjetë bibliotekat e lagjeve të Tiranës që janë rikrijuar me një grusht librash të dhuruara. Interesi ndaj tyre do të shkaktonte një sensacion të bujshëm, një ndjenjë të dëshirueshme. Mos harroni se gjashtëdhjetenjë bibliotekat e bashkive, njëmbëdhjetë bibliotekat e lagjeve të Tiranës dhe tridhjetë bibliotekat e mëdha universitare dhe të instituteve qendrore do të krijonin një hapësirë të vërtetë për librin e investuar nga shteti për gjithë komunitetin. Kjo është edhe sfida më e madhe. Sepse librat e tyre të paktën do të jenë deri në pesë kopje. Por shteti ynë këtë nuk e bën. Prandaj dhe gjuhën shqipe po e çon drejt vdekjes vetë shteti shqiptar. Sepse pa biblioteka shtetërore dhe pa autorë shqiptarë në shtetin me emrin Shqipëri s’mund të ketë gjuhë shqipe...

Edhe një shtesë të vogël për *autorët e rinj*, që shfaqen tejet shprehës dhe me një seriozitet jo të shtirë, që i bën edhe më të afërt me letërsinë e vërtetë. Kjo domethënie i ka dhënë vetëdijes së tyre guxim, novatorizëm, po dhe një frikë nga realiteti i vështirë ekonomik, që ua shndërron me kohë në ndëkryerje dhe shpirt revolte. Nganjëherë puna e tyre krijuese tjetërsohet në ndrojtje ose në një simpati të fshehur. Tek e fundit për ta askush nuk investon, as edhe shteti i tyre...

Roli i botuesve, librarive dhe bibliotekat

Mendimi im në lidhje me këto tri shtylla të librit është i njohur, pa shtrirje gjeografike dhe pa ndonjë gjë interesante. Në hapësirën e njohjes botuesit janë të gjithë *të dashur* nga pushteti, kurse në shpërndarjen e kontributeve janë ca të nënës e ca të njerkës. Më të përkëdhelurit e botuesve kanë një sukses të bujshëm dhe madje turbullues. Tek botuesit shqiptarë luftohet nga të katër anët. Paralajmërimet e tregut, pastaj, u vijnë përditë nga tregu dhe bëhen përherë e më tepër gati të papërballueshme. Tek botuesit aspak të përkëdhelur nga shteti s’ka ekstravagancë, s’ka as qetësi, por ka punë të jashtëzakonshme dhe mbijetesë. Nuk flitet më për fitime, po vetëm për humbje. Dhe libri aq magjepsës, tejet elegant, kthehet në mall të çfarëdoshëm tregu... Botuesi është gjithnjë e më shumë në skajet e sfidës së mbijetesës ekonomike.

Libraritë janë ishujt e Robinsonit, kështu mund t’i quaj për shkak të vetmisë së tyre, skutave ku janë futur ku sigurisht bëjnë sikur tregtojnë libra dhe *farefisin* e librit. Ato, mjeranet, duket sikur presin t’i përkëdhelin ca shirat e fatit. Libraritë le që janë të tejdukshme po për më keq edhe gjysmë lakuriq e gjithnjë duke u qarë. Libraritë u hakërrehen me tërbim vetëm autorëve shqiptarë, të cilët nuk i shohin dot me sy dhe s’i ndjekin dot, sepse pikërisht ata me trastat nëpër duar i bëjnë të duken si bisha. E tërë kjo gjendje dhe marrëdhënie ndodh nga halli i një indiference dhe talljeje të përçudshme të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare. Dhjetëra libraritë shqiptare janë në gjendje të pakuptimtë, as nuk dinë ç’kërkojnë, ato hapen e mbyllen, urrejnë, dashurojnë, mallkojnë, ndërsa punojnë shumë, bëjnë marrëzira pa fund nga mërzia. Pra ato fare pak librari që ka Shqipëria (për turp!), nuk mund të quhen librari, nuk janë afruar fare tek institucioni i *librarisë*, nuk janë gjithëpërfshirëse dhe tejet të rrëmujshme, pa njohje dhe me fare pak reklamë... Shteti ynë (ministria e kulturës, natyrisht!) as është kthyer ndaj tyre dhe herë-herë kërcëllin dhëmbët ndaj tyre.

Bibliotekat. Për to folëm pak më lart. Ato, të zezat biblioteka, janë portreti i vërtetë i shtetit shqiptar, me një trishtim mistik, vuajtjeje të fshehtë, pa pikën e ndjeshmërisë që zakonisht bart libri. Përse vuajnë? Po ja, për fare pak investime, fonde, «hakmarrje», «ndëshkim», liri, «luks», njerëz. Se edhe njerëzit u çmësuan, ose u pëlqen të ecin kundër rrymës... Harrojmë që s’ka as njerëz të rinj më, i ka përpirë mërgimi. E kur s’ka njerëz (s’ka biblioteka, domethënë!) shteti ynë delirant, pse të investojë? Përfundimi: gjuha shqipe po vdes...

Çfarë duhet përmirësuar dhe si duhet të sillemi përballë një lexuesi të ri?

Ja kështu pyet ministria jonë e kulturës. E ç’të themi tani? Më lart i vumë «vulën» atyre me gjendjen që kanë. Lexuesi i ri, ministria duhet ta dijë, patjetër, janë kryeneçë, disi të egër, nervozë, me vështrim të ndezur, për çudi edhe me gojën hapur dhe gjoksin përpara, portrete të jashtëzakonshëm. Ata, lexuesit e rinj, nuk shtyjnë vagonë me mineral, as hapin ara në mal, as shkulin pyje dhe ndërtojnë hekurudha, as gropa për të mbjellë pemë..., ata me siguri pinë drogë, merren me seksin dhe as që i hapin librat, madje nuk u mjafton as qielli e as toka, nuk u tepron as kokëfortësia, nuk duan t’ia dinë për vetminë, sëmundjet, sido që ndihen të zhgënjyer e plot mërzi, por megjithatë të panënshtruar, të papërfillur, të mallkuar e të përmallur...

Kohë të reja, qasja me komunikime të reja

Vërtet që jetojmë kohë të reja, kohë që kërkon qasje *për* dhe *me* komunikime të reja. Këtu, miqtë e mi, nuk do folur fare. Pa qenë e para (libraria, biblioteka, reklama e tmerrshme për librin (domethënë edhe reklama me hak, e munguar!), herë-herë librat, paratë e taksapaguesve shqiptarë aq të domosdoshme për librat, atëherë nuk ka vend të hapim gojën për kohët e reja dhe qasjet me komunikime të reja. E tepërt! S’ka nevojë për diskutime imagjinare...

Hapja drejt botës dhe kulturave të tjera

Tani i erdhi fundi diskutimit tonë për librin dhe institucionet e tij. Dhe të diskutojmë për hapjen ndaj botës dhe për kulturat e tjera. E kam thënë edhe më parë. Shkrimtari i ri shqiptar duhet të shkruajë vetëm në anglisht dhe t’i drejtohet gjithë botës me veten e tij. Këtu duke u gërricur me gjuhën shqipe, me entet botuese, me libraritë dhe bibliotekat, herë-herë duke u kapur fytafyt me to apo edhe duke përkëdhelur, dëshmojnë se ata duhet t’i drejtohen botës, hapjes së madhe ndaj botës duke iu drejtuar lexuesve në anglisht. Atëherë shteti tjetër shqiptar, duhet vetiu të lëvizë fort për ta mbrojtur gjuhë e vjetër shqipe, madje edhe ta shpallë monument kulture, «mbrojtur nga shteti», sepse thjesht s’do të ketë më lexues...

Tiranë, më 14 janar 2020

Parathënie për enciklopedinë “Shqiptarët në Artin Botëror”
të Prof. Ferid Hudhrit

KOMUNIKIM FISNIK MIDIS POPUJVE NËPËRMJET PIKTURËS

Nga **ISMAIL KADARE**

Në sallonin e pritjes të njërës prej kështjellave mesjetare të Luarës në Francë, të Borgarit në Blezua, midis portreteve të njerëzve e të kapedanëve të shquar të kohës, është edhe një portret i Skënderbeut. Merret me mend se një portret i vendosur në një dhomë pritjeje, në një mënyrë ose një tjetër, tërheq vëmendjen e mysafirëve dhe zgjon bisedën për të.

Portreti dhe biseda për Gjergj Kastriotin në një dhomë kështjelle mesjetare europiane nuk ishte as gjë e rrallë, e as rastësi në shekullin e pesëmbëdhjetë e në shekujt e tjerë më pas. Shqiptarët po derdhnin gjak pikërisht në portat e Europës. Lajmet për të dhe për dyndjet osmane, që ata kishin frenuar bashkë me popujt e tjerë të Ballkanit, vinin të turbullta e plot ankth nga kryeqyteti në kryeqytet, nga kështjella në kështjellë. Flitej me pasion për ndihmën që duhej të jepej, për rrezikun që kërcënonte Europën, për nevojën e organizimit të një kryqëzate të re paneuropiane, në krye të së cilës mund të vihej Gjergj Kastrioti.*

Kaluan kështu mjaft vjet. Bashkë me kalimin e rrezikut, kancelaritë e Europës e harruan shumë shpejt popullin e vogël, që u gjet në qendër të ciklonit. Interesi u zbeh nga shekulli në shekull, pasionin e zëvendësoi indiferenca dhe kjo vazhdoi gjer në formulën cinike të kryeministrit anglez Chamberlen, në mëngjesin e 7 prillit 1939, në çastet kur Shqipëria u pushtua prej fashizmit: “Anglia s’ka ndonjë interes të veçantë në Shqipëri.”

Por ndërsa u harrua prej shteteve e kancelarive, Shqipëria nuk u harrua prej letërsisë dhe artit europian. Bajroni, Vivaldi, Delakrua dhe dhjetëra e dhjetëra shkrimtarë, kompozitorë e piktorë të njohur, vazhduan të kërkojnë e të gjejnë motive të papërsëritshme në dramën, tingujt dhe ngjyrat e këtij vendi.

Anglia e Chamberlen-it mund të mos kishte interes për Shqipërinë, por Anglia e Bajronit kishte tjetër mendim. Dhe për cilindo ishte fare e qartë se ky i dyti ishte mendimi i vërtetë i një vendi dhe i një populli.

Vice-versa, populli shqiptar në këngë e në balada prekëse ka folur shpesh për popujt e tjerë të kontinentit. Në këngët e tij nuk mungojnë gëzimet e hidhërimet e tyre, nuk mungojnë as Parisi, as Vjena, as Londra, Athina e Venediku.

Me librin “Shqiptarët në vepra të piktorëve të huaj” (1989), Ferid Hudhri na dëshmoi, për herë të parë në mënyrë bindëse, atë komunikim fisnik midis popujve të realizuar nëpërmjet pikturës. Pas një pune të gjatë hulumtuese ai na dëshmoi se me dhjetëra kanë qenë piktorët që, duke udhëtuar nëpër Shqipëri, kanë marrë me vete, për t’i ringjallur më pas në pëlhurë, ngjyrat dhe fytyrën komplekse të saj e të shqiptarëve. Të tjerë që, për arsye të ndryshme, nuk erdhën dot fizikisht, erdhën me mendjen dhe përfytyrimin e tyre, huajtën kostume shqiptare nga kolegët, shpejtuan në studiot e tyre dhe atje, me ndihmën e atyre ngjyrave të paharrueshme, të asaj çka kishin dëgjuar dhe të intuitës që kanë artistët e vërtetë, krijuan tablo të një vlere të pakontestueshme.

Pas shumë kërkimeve e hulumtimeve të tjera, gjatë 30 vjetëve të fundit, studiuesi Hudhri me enciklopedinë “Shqiptarët në Artin Botëror”, po na e sjell më të plotë krijimtarinë me temë shqiptare të autorëve të huaj; nga 118 artistë që u bënë të njohur në librin e parë me këtë temë, në botimin e ri paraqiten 1450 piktorë, skulptorë, grafistë, koleksionistë dhe autorë të tjerë, bashkë me veprat e tyre si dhe historikun e lidhjeve me Shqipërinë.

Enciklopedia është një provë më shumë për kontaktet e pandërprera të shqiptarëve me Perëndimin, për interesimin e artistëve, studiuesve, udhëtarëve dhe hulumtuesve të ndryshëm perëndimorë. Nëse dikush nuk do të kishte parë larminë e pafundme të imazheve që ofron kjo enciklopedi, do ta kishte të vështirë të besonte se të huajt kanë pikturuar apo vizatuar kaq shumë imazhe të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Kjo enciklopedi është një pasqyrë e mbajtur nga të huajt ku ne shohim imazhin tonë; mbase nganjëherë na duken tepër të largët ata shqiptarë e ato shqiptarka që na shohin nga veprat e artit, nganjëherë çuditemi sa pak na ngjajnë dhe sa të largëta na duken qëndrimet dhe sjelljet e tyre, na habit galeria e pafundme e tipave shoqërorë nga të gjitha shtresat e popullsisë, tipa dhe karaktere të veçanta, herë romantikë dhe herë prozaikë, me një larmi të pafundme materiali etnografik kostumesh, orendish dhe mjedisesh. Pra, gjerësia e hapësirës kohore dhe larmia topografike që përmban kjo hartë imazhesh është njëra nga vlerat e padiskutueshme të kësaj enciklopedie, e



paarritur nga studimet e mëparshme në fushën e arteve pamore.

Figurat e arbëreshëve ishin ndër të parat imazhe që u krijuan nga autorët europianë. Ndryshe nga bashkatdhetarët e tjerë që mbetën nën okupimin osman, shqiptarë që emigruan në Itali u afruan më pranë botës së artit perëndimor. Kështu, krahas piktorëve vendas, si B. Pinelli, Mulinaretto, E. Maria Bergler, A. Cefaly, imazhet e arbëreshëve u përjetësuan edhe nga francezët F. Magaut, C. Corot, G. Vuillier, belgu J. F. Voet, danezi A. Kushler, maltezi V. Fenech dhe autorë të vendeve të tjera. Ndërsa *veshjet shqiptare*, të pranishme edhe në studio të artistëve të huaj, gjatë shekullit

Ismail Kadare dhe autori i librit, Ferid Hudhri, shtator 2019

XIX u bënë motivi kryesor për shumë vepra arti. Krahas albumeve më të hershme me *kostume të zgjedhura nga Shqipëria* të autorëve J. Cartwright, O. Stackelberg, L. Dupre, P. Beresford (të botuara midis viteve 1822-1855), të veshur me kostum shqiptar u pikturuan disa personazhe të njohura të kohës. Pas poetit Byron, Phillips ka përjetësuar në telajo edhe Sir Austen Henry Layard-in, shkrimtarin Edward John Trelawny dhe kolonelin George Vivian me rroba shqiptare. Me kostumin shqiptar janë pikturuar apo fotografuar edhe shkrimtarët Alexandre Duma, Pier Loti, aktorja amerikane Mary Anderson si dhe personazhe të tjera të njohura.

Krahas artistëve, në vendet perëndimore u bënë të njohur edhe disa koleksionistë me origjinë shqiptare. Vila Albani, e themeluar nga Aleksander Albani në Romën e vitit 1760, vlerësohet si një nga vilat e para Muze në Europë. Duke bashkëpunuar me Johann Winckelmann-in dhe piktorin Rafael Mengs, ai grumbulloi një koleksion të pasur nga antikiteti dhe arti bashkëkohor, duke e shndërruar Vilën në qendër diskutimesh midis artistëve italianë dhe nga vende të tjera. Familja Durazzo në Genova, me financimin e artistëve krijoi një nga koleksionet më të çmuara në Itali, me 400 piktura, skulptura e krijime të tjera nga artistët më të njohur të kohës. Në ekspozitën që u hap në vitin 2004 në Gjenovë, të titulluar "Da Tintoretto a Rubens", nga ai koleksion u ekspozuan edhe veprat e piktorëve të shquar Rembrandt, Veronese, Dürer, Mantegna, Fragonard, Rigaud etj.

Pas paraqitjes së veprave të veçanta nëpër sallonet e kryeqyteteve europiane, me tablotë kushtuar shqiptarëve u organizuan disa ekspozita të posaçme. Midis 90 ekspozimeve më të rëndësishme, që fillojnë me peizazhet e piktorit Hermann Urban në Munihun e vitit 1900, mund të veçojmë: grupin prej 23 artistësh italianë, që pasi pikturuan disa javë nëpër Shqipëri, paraqitën 94 vepra në ekspozitën e Barit të vitin 1939; 18 artistët polakë (midis tyre 7 gra e vajza) që zbritën me anije në Durrësin e vitit 1955, realizuan 100 peizazhe, tablo e vizatime, për t'i ekspozuar po atë vit në Varshavë; ekspozitën "Nëpër Shqipëri" të vitit 1959 në Moskë me 215 punime artistike (numri më i madh i tablove me temë shqiptare që është ekspozuar deri tani nëpër botë); apo "Përshtypjet nga Shqipëria" të dy piktorëve të njohur japonezë Inosuke Hazama dhe Kimiko Amabe, të cilët i paraqitën në Tokion e vitit 1965, kur shqiptarët sapo ishin shkëputur nga blloku i shteteve komuniste.

Kështu, me motive nga më të ndryshmet të botës shqiptare u realizuan shumë e shumë vepra arti. Nga pallati i Dozhëve në Venedik dhe katedralja Duomo e Milanos te muzetë e Londrës, Parisit, Vjenës, Moskës, Budapestit, Hamburgut e gjer në Bruklin të Nju-Jorkut, në dhjetëra muze të tjerë, në kështjella, galeri e koleksione private gjenden vepra e kryevepra piktorësh të vendeve nga më të ndryshmet me temë shqiptare. Paolo Veronese ka lënë në afresk kështjellarët e së fundmes fortesë shqiptare që ra në sulmin osman, asaj të Shkodrës. Po nga ajo periudhë Dürer, Rembrandt, Tiziano, Giorgione, Mestrović dhe autorë të tjerë të njohur të artit botëror kanë bërë vizatime, gravura, tablo e statuja për Skënderbeun; "Shqiptarja" dhe "Haideja" të Camille Corot-së botohen në albumet që përmbledhin kryeveprat e pikturës botërore. "Valltarët shqiptarë" e Alexandre Decamps konsiderohet si tabloja më e bukur e muzeut të Brestit. Orientalistët e njohur Léon Gérôme, Charles Bargue, Charles Gleyre, Paja Jovanović krijuan korpusin më piktoresk të shqiptarëve me veshje tradicionale. Midis shumë tablove me temë shqiptare të Eduard Lirit, "Mali i Tomorrit" është quajtur ndër dhjetë më të bukurat e të gjithë krijimtarisë së tij, e kështu me radhë, tablotë e artistëve më të njohur Anton van Dyck, Nicolas Poussin, Jean Vanmur, Ary Scheffer, Carlo Crivelli, Van Gogh e të tjerë, janë dëshmi artistike komplekse e plot vlerë, një akt dashurie ndaj shqiptarëve e Shqipërisë.

Kultura shqiptare ka qenë përherë mirënjohëse ndaj çdo mesazhi miqësor që vinte nga popujt e tjerë. Mirëkuptimit ajo i është përgjigjur me mirëkuptim, miqësisë me miqësi dhe kjo është në traditën më të mirë të mendësisë kombëtare shqiptare. Kultura e Shqipërisë së sotme ka të njëjtin qëndrim, të njëjtën ndjeshmëri ndaj çdo akti miqësor të artit e të kulturës botërore, i shprehur ky në letra, muzikë apo pikturë.

Ribotimi në gjuhë të huaja i librit të parë dhe hartimi i kësaj enciklopedie që lexuesi ynë po merr në duar, e ridëshmon më qartë këtë.

Paris, 2019

PËRBINDËSHI I RRUMBULLAKËT

tregim nga

Alberto Moravia

Tregimi i mëposhtëm "Përbindshi i rrumbullakët" i Alberto Moravias botuar në 1976 nga Mondadori, bën pjesë në përmbledhjen me 30 tregime të titulluar "Boh" (në proces përkthimi nga unë, D.K.). Boh *është shprehja tipike italiane që përdoret më fort me gjuhën e trupit, shprehje e cila në këtë libër përmbledh gjithë dyzimet, moskuptimet, keqkuptimet që shekujt ia kanë akumuluar e depozituar në nënndërgjegjen e saj e që vështirë se do të arrijë ndonjëherë t'ia shpjegojë partnerit të saj. 30 tregime me 30 profile të ndryshme psikologjike grash! Njohës i thellë i dinamikave cerebrale e të pandërgjeshme të gruas, Moravia na jep një afresk sublim të vizionit të tij "feminist". Dhjetëra nuanca të holla të psikës femërore të treguara me një gjuhë të prerë, pa zbukurime, lakonike, gdhendëse, me raste mizore deri aty ku secila grua duke i lexuar do ta gjente veten tek të paktën njëri prej tyre. Filli i kuq që i përbashkon e i përshkon këto tregime, ai i botës asnjëherë të njohur saktësisht të gruas, na vjen me ngjyrat më të gjalla të një narrative mbresëlënëse.*

Ka njëzetë vjet tashmë që e kam lexuar Platonin, pikërisht atëherë kur isha studente dhe po diplomohesha në mjekësi. Nga ai lexim më ka ngelur në kujtesë veçanërisht njëra prej përrallave, ajo e hermafroditit, sipas së cilës në zanafillat e njerëzimit ka ekzistuar një përbindësh i rrumbullakët me dy kokë, me katër krahë, katër këmbë, dy palë të ndenjura dhe dy sekse. Zeusi, i shqetësuar për forcën e përbindëshit vendosi ta dobësonte forcën e tij kështu që e ndau në dy pjesë të barabarta, siç thotë Platoni, ashtu siç ndahet një vezë e zier me një teh të mprehtë. Që nga ajo kohë, këto dy gjysma seksesh, njëri femëror dhe tjetri mashkullor, shëtisin nëpër botë si të ndërkryer duke kërkuar gjysmën e seksit të ndryshëm që t'i plotësojë dhe në këtë mënyrë t'i lejojë që të rikrijojnë përbindëshin e fillimit. Pse më ka mbetur në kujtesë kjo përrallë? Sepse sipas meje kjo nuk është një përrallë, por një e vërtetë. Megjithë profesionin, kulturën, zgjuarësinë dhe përvojën time, unë jam përjetësisht në një kërkim të ankthshëm e shkatërrues të gjysmës time mashkullore. Ky kërkim i vazhdueshëm dhe i dëshpërueshëm më çon të bëj marrëzira si për shembull tani teksa jam duke ngjitur shkallët e një shtëpie popullore në kërkim të një farë Marioje, një djalosh i ri që punon si kamarier në plazh në krahët e të cilit jam ndjerë e plotë dhjetë ditë më parë ndërsa pushoja në një hotel të Cirçeos.

Natyrisht që ashensori është i prishur kështu që kur arrij në katin e gjashtë pasi kam bërë me vrap dymbëdhjetë palë këmbë shkallë, mbetem të paktën për një minutë pa lëvizur para derës duke u mbushur me frymë. Mbi pllakëzën prej tunxhi tek dera e jashtme është shkruar me shkronja korsive "Elda-moda", ndoshta për t'i dhënë paksa elegancë. Elda është emri i nënës së Marios. Ajo pllakëzë mendjemadhe dhe naive kontraston me thjeshtësinë e derës prej druri të lyer me një ngjyrë hiri të shëmtuar, me dyshemenë e ngushtë të mbytur nga një diell i egër, me shkallët e ndyra, me gjithë shtëpinë brenda. Ja, tani nuk dihas më. Zgjas dorën dhe i bie ziles.

Dera hapet menjëherë si për të vërtetuar vogëlsinë e apartamentit. Një grua me përparëse të zezë prej rrobaqepëseje, me një metër prej dylli të verdhë mbi sup dhe me fije peri të bardhë të shpërndarë kudo mbi gjoks, pa dyshim nëna e Marios, shfaqet në prak. Është një grua e bukur, por me një bukuri të rrënuar dhe të zymtë. Amësia, puna, ushqimi e kanë deformuar dhe rënduar. Duhet të ketë moshën time ose disa vite më pak, por midis nesh sigurisht që unë dukem më e re, edhe sepse flokët e mi janë të lyer, ndërsa të sajtë janë të thinjur.

Më shikon me mosbesim dhe më pyet se çfarë kërkoj. I përgjigjem me një gënjeshtër që gjithsesi mban një të vërtetë. - Djali juaj është duke u kuruar tek unë. Më telefonoi mbrëmë duke më thënë se nuk ndjehej mirë dhe donte që unë ta vizitoja, prandaj erdha.

Pse them që është një gënjeshtër që mban një të vërtetë? Sepse kështu filloi dashuria jonë, në një dhomë shërbimi të hotelit në të cilin qëndroja unë dhe ku të zihej fryma. Mario gjendej i shtrirë mbi një shtrat portativ të bërë rrëmujë nën përpëlitjet e një krize kolike. Unë rrija në anë të shtratit dhe i

mbaja dorën. Ai mundohej të kontraktohej sa më pak që të ishte e mundur dhe, ndërkohë, me sytë e tij të ankthuar kërkonte gjatë gjithë kohës të mitë.

E ëma që duket si e mësuar me këto lloj gjërash, nuk çuditet as nga prania ime, por as nga preteksti. Thotë me një zë të nënshtruar: Po shkoj të shoh nëse është në shtëpi. Më kthen shpinën pa më ftuar të hyj brenda dhe zhduket pas një perdeje prej stofi që ndan hyrjen nga pjesa tjetër e apartamentit. E mbetur vetëm, ngurroj pak e pastaj hyj brenda. Hap perden, shikoj: një korridor i vogël me një derë prej xhami në fund që pa dyshim duhet të jetë banjoja; pas saj ka tri dyer. Llogaris: njëra derë është e kuzhinës, njëra për dhomën e provave, njëra për dhomën e Marios. Po e ëma ku flen? Sigurisht në dhomën e provave mbi një divan. Duke menduar, si të themi, topografikisht, mbaj vesh. Dera, që sipas meje i takon dhomës së Marios ka mbetur e hapur përgjysmë nga ku dëgjohet qartazi zëri i tij që mbyturazi diskuton me të ëmën. Papritmas, ajo shfaqet sërishmi aq sa unë nuk arrij as të kthehem edhe njëherë tek hyrja. Me zërin e saj të trishtë më thotë: Më vjen keq, por im bir nuk ndodhet këtu! E shikoj drejt e në sy. Ajo i reziston shikimit. Duke u dridhur e gjitha, bërtas: Ju gënjeni, djali juaj është këtu, ia dëgjova zërin! Ndërsa them këto fjalë turrem për nga dera e dhomës së Marios. Në këtë moment Mario del nga dhoma dhe më qëndron përballë.

Flokët e zinj e të ndritshëm i ka të shpupurishur; është në brekë e kanotiere dhe duket që sapo është ngritur nga shtrati. Vë re që mban nën sqetull një peshqir. Budallallëkshe mendoj se nuk e mbaja mend kaq të shkurtër, kaq të përpjestuar mirë dhe kaq leshatak. Por, në të njëjtën kohë provoj një si ndjesi të shtyrjes drejt tij, si e çmendur dhe me urgjencë, aq sa, nëse nuk do ta përmbaja veten, me siguri do të vrapoja tek ai për ta përqafuar, për t'iu ngjeshur trupit të tij me timin. Pikërisht ajo gjysma platonike që, pas një kërkimi të gjatë, ka gjetur më së fundi gjysmën tjetër. Hap gojën, shqiptoj: Mario... Ndalem si e paralizuar nga një mendim i menjëhershëm që Mario, për ndonjë arsye që nuk e di, as nuk do t'ia dijë për mua dhe, si pasojë, kam bërë gabim që e ndërmora këtë aventurë për të ardhur deri në shtëpinë e tij me pretekstin e marrë të vizitës mjekësore. Është pikërisht kështu. Mario më shikon një moment i ngrysur dhe ja ku nga ajo gojë aq e dashur shpërthen përulëse dhe e shëmtuar e shara, të themi nga ato tradicionalet e një burri të ri ndaj dashnores më të madhe në moshë. Shtoji gjithë kësaj edhe ndryshimet e shtresës shoqërore, të kulturës që, në imagjinatën time platonike, i kisha konsideruar si elementë të destinuar për t'u integruar reciprokisht. Shtoji, së fundi, të folurën e pagdhendur romane e përshtatshme për të asgjësuar sa hap e mbyll sytë edhe lidhjen më të fortë dashurore, me fraza dialektore të tipit: Ej, ç'dreqin don? Po kush të njeh ty? Je parë në pasqyrë ti, apo jo? Pa shih plakën njëherë, na dashka... - e të tjera si këto.

Frazat e tij më ndjekin e më mbështjellin ndërsa, e përhumbur, rrekem të tërhiqem si një pulë e frikësuar dhe e gafrruar që ikën për të shpëtuar nga goditjet e fshesës së amvisës të tërbuar. Në këmbë tek dera, e ëma shikon me dyshim por edhe e qetë, herë mua herë Marion, mund të thuhet si me një simpati të njohur për mua. E kapërcej dhe dal në shkallë, por jo me aq nxitim sa të mos shoh fyerjen e fundit ndërsa Mario futet në banjo duke përplasur me zhurmë derën me xhama.

Pas kësaj skene, më ndodh diçka e pazakontë, por e saktë; çdo mëngjes, aty nga ora pesë, më del gjumi e tronditur dhe menjëherë filloj të mendoj Marion, ose më mirë, nuk mendoj atë në kuptimin

e shprehjes “të mendoj gjithmonë” që në fund të fundit do te thotë të mos mendosh, por t’i lëshohesh ndjenjës. Jo! Më ndodh që me imagjinatë përsëris skenën aq poshtëruese të dëbimit tim nga shtëpia e tij. E shoh veten tek i bie ziles së derës, tek gënjej të ëmën dhe tek hyj në shtëpi. Shoh Marion tek shfaqet duke më mbërthyer me një shikim nga koka tek këmbët, tek zbrazet kundra meje dhe tek futet ne banjo duke përplasur derën. Pikërisht në këtë pikë, mendoni pak, sillem në anën tjetër dhe, më zë gjumi. Ja pra, nëse arrini të kuptoni këtë do ta merrni vesh cili është dallimi ndërmjet të kujtuarit dhe ripërjetimit. Të kujtosh do të thotë të nxjerrësh nga kujtesa një person, një ngjarje, t’i kundrosh ashtu siç bën me një gjerdan të vjetër që rrinte i mbyllur në një sirtar e pastaj ta vendosësh përsëri aty, do me thënë në atë të kujtesës dhe të mos e mendosh më. Të përjetosh përsëri, do të thotë të provosh e të riprovosh, pa fund, ndjesitë

që ai person apo ajo ngjarje kanë ngjallur tek ne ndërsa i përjetonim. E në fakt, kujtohet vetëm një herë, por përjetohet pafundësisht. Me një dallim ama: askujt nuk i bie ndër mend të ripërjetojë ndjesitë e pakëndshme. Përjetohen vetëm ndjesitë e pëlqyeshme, të tjerat sforcohesh t’i harrosh. Si shpjegohet atëherë që unë, çdo mëngjes, me qindra herë, kthehem të kujtoj skenën e dëbimit nga shtëpia e Marios duke u ndalur veçanërisht në detajet më poshtëruese e më të pamëshirshme? Pse ngurroj, e topitur dhe e mahnitur që të shijoj sërishmi atë dhimbje të thekët si të ishte një kënaqësi turbulluese? Mendohem gjatë dhe, në fund i them vetes që faktikisht, gjatë atyre rikthimeve të kujtimeve mëngjezore, një si alkimi psikologjike ma shndërron gjithë atë dhimbje në kënaqësi. Mund të thuhet: mazokizëm. Ndoshta.

Po si është e mundur që të pajtohen mazokizmi me këtë dëshirë të ankthshme për të gjetur gjysmën tjetër, për të formuar edhe një herë përbindshin e rrumbullakët mitik të Platonit? A mund të quhet i plotësuar një person i ndarë në dy pjesë, njëra prej të cilave poshtëron, ofendon e degradon tjetrin? Me sa duket, po. Ajo dhimbje e imja epshore, më së fundi, pas disa muajsh, shndërrohet në një diçka të pashijshme, të dobët. Skena e dëbimit tim nga shtëpia e Marios zbehet, fillon të fshihet përgjysmë ashtu si një film i vjetër i konsumuar nga koha e nga përdorimi. Por, fatkeqësisht, tashmë jam mësuar me atë ëndje të kobshme, kam nevojë absolute të provoj çdo mëngjez vuajtjen e atyre pak minutave rrënqethës. Kështu, marr një vendim ndoshta të pabesueshëm por, në gjendjen në të cilën ndodhem më ngjan mjaft logjik. Do të paraqitem përsëri në shtëpinë e Marios, do t’i nxjerr të njëjtin pretekst të pafytyrë të vizitës mjekësore. Do të dëbohem sërishmi në të njëjtën mënyrë fyerëse, madje ndoshta Mario do të më kapë për flokësh e do të më plasë për tokë tek hyrja e apartamentit e pastaj duke më shqelmuar do të më hedhë për shkallësh. Ashtu si ai i droguari që ka marrë dozën e preferuar të tijën, do të kthehem në shtëpi me goxha “furnizim” poshtërimi aq sa më duhet për ta zgjatur akoma edhe për një kohë të gjatë.

Pa ngurruar e vë në jetë planin. Herët në mëngjes paraqitem në pallatin “popullor”, i ngjes në këmbë (ashensori është ende i prishur) të gjashtë katet, i bie ziles, e ëma ma hap derën, dhe recitoj gënjeshtrën e vizitës mjekësore. Pres që mamaja e tij të më shtyjë me atë trishtimin e saj të dellëzuar me simpati. Pres që Mario të shfaqet dhe të hakërrehet kundër meje. Asnjë prej këtyre. E ëma, gjithmonë me atë pamjen e trishtë më fton: Mund të shkoni drejt e në dhomën e tij. Është në shtrat. Dera e fundit djathtas! - dhe largohet. Më shumë e vdekur se e gjallë bëj disa hapa dhe trokas në derë. Nga brenda më thuhet që të hyj. Ja, dhoma e vogël dhe e veshur me figura artistësh e lojtarësh futbolli të prera nga revistat. Mario është i shtrirë në shtrat, në shpinë ndërsa duart i ka të mbledhura poshtë zverkut, në brekë e kanotiere ashtu si herën e fundit. Nuk ngrihet, nuk lëviz, kufizohet të më thotë me një zë sa të ashpër aq edhe të sjellshëm: A mund ta di pse nuk u bëre më e gjallë? Apo ngaqë atë ditë isha pak i ashpër? A e di që je vërtetë e çuditshme?

Papritmas impulsi për t’u hedhur tek ai për ta përqafuar, për ta ngjitur trupin tim me atë të tijin më kalon si një magji. Më pas, ndodh diçka automatike, mekanike. Ulem tek bordura e shtratit, i marr pulsin dhe i numëroj të rrahurat. Ai proteston, në fillim i pasigurtë pastaj me më shumë vendosmëri. Nuk i vë vesh. Me ftohtësi profesionale e refuzoj përpjekjen e tij për të më përqafuar. Ngrihem. I them që nuk është në gjendje të mirë. Marr bllokun e recetave, shkarravis një dhe ia jap. Kësisoj, pa i dhënë kohë që ta rimarrë veten nga habia, dal nga dhoma e pastaj nga apartamenti dhe zbres shkallët.

Ndërsa hip në makinë për të filluar xhiron e zakonshme të vizitave të mia, papritmas më vjen për të qeshur. Në fakt, më vjen ndër mend që përbindëshi i rrumbullakët i Platonit duhet të ketë ecur në mënyrë qesharake duke u rrotulluar me ato katër krahët e tij dhe me katër këmbët, ashtu si akrobatët apo si disa hyjni indiane. Pikërisht kështu! E ç’mund të bëjë tjetër një qenie kaq e çuditshme e cila bashkimin e saj ia detyron ndarjes, forcën e saj ia detyron dobësisë dhe gëzimet, dhimbjeve?!

Përktheu nga origjinali: Diana Kastrati

‘Meshkujt janë kudo’: Svetlana Alexievich do të themelojë një shtëpi botuese për shkrimtaret femra

nga Paula Erizanu

Fituesja bjelloruse e Çmimit Nobel, Svetlana Alexievich, po themelon një shtëpi botuese të re e cila do t’i dedikohet ekskluzivisht botimit të shkrimtareve femra.

Në një intervistë për gazetën bjelloruse Nasha Niva, Alexievich tha se shpreson të rregullojë raportin e pabarabartë të veprave të botuara nga autorë meshkuj dhe femra.

“Meshkujt janë kudo dhe nga shkrimtaret femra botohen shumë pak vepra”, tha ajo.

Alexievich, e cila e mendoi këtë ide gjashtë muaj më parë, tha se shpreson që kjo do të ketë “ndikim në vetëbesimin e shkrimtareve femra dhe në dëshirën e tyre për të shkruar”.

Shtëpia botuese do të hapet brenda pak muajve dhe titujt e parë që do të botojë, do të jenë prej shkrimtareve bjelloruse Eva Veznavets dhe Tatyana Skorkina.

GJAKU I HËNËS

poezi nga

Shazim Mehmeti

AFSHE!...

Afshe, afshe, afshe!
Gojë të panumërta,
që i japin mirëseardhjen
këtij agimi të përgjumtë.

Qiej të ndezur,
të padurimtë -
gjuhë të përsosura kaltërie,
që bien e bien,
e nguten të prehen
mbi përkëdhelitë e bardha
të reliefit të çastit.

Gjethnajë,
që ëndërron ta përthithë
gjithë klorofilin e ditës.

Pështërima qeniesh ajrore,
zogj që përzihen
me tufa të pafundta
fluturash jargavane.

Dritë e hollë, e hollë,
që bie, jeshilohet
sipër krahëve të mi.

Këto dy krahë
që më shumëzohen
për njëmijë
dhe lëshohen në prekje,
në përpushtim,
gropëzave dritëprarime
të barkut tënd...

VLIM

I kam ndigjue
shtërzimet e gjata t'natës,
n'çastet e fundit
t'shtatzanisë shenjte,
dhe kam qa.

I kam pa
edhe kambët e vogla t'mëngjesit,
n'lindjen e tij praptas,
dhe kam qa.

Kam vlue n'zemër -
lotë gjaku kam derdhë,
kur kam pa
si bahet dritë
mishi i territ...

YLL MEDITUES, MBI DEGË BLIRI, ULUR...

Ulur,
mbi këtë degë bliri, meditoj.
Për shikimin, për shijimin.

Shoh.
Shoh përtej muresh.
Shoh përtej gjumit.
Përtej terri shoh, përtej nate.
Shoh në vet zemrën e qiellit,
dhe përtej ëndrrës qiellore.
Në vet zemrën e diellit,
dhe përtej ëndrrës diellore.
Shoh në gëzim, shoh në pikëllim.

Dhe shijoj, shijoj, shijoj.
Në mure e përtej muresh.
Në terr,
në zemrën e territ,
dhe përtej territ.
Në natë,
në zemrën e natës,
dhe përtej natës.
Në diell,
në zemrën e diellit,
dhe prapa diellit.
Shijoj në gëzim,
dhe përtej gëzimit.
Shijoj në pikëllim,
dhe përtej pikëllimit.

Nuk pres. Nuk logjikoj. Jetoj.
Jeta nuk është ëndërr.
Jeta nuk është pritje
që nuk mbaron.
Jeta është fruti
që duhet shijuar,
në këtë çast.
Çast për çast.

Jam plak, dhe i ri.
Jam i ri, dhe plak.
Tepër i ri, dhe tepër plak.
Miliona vite drite mbaj mbi shpinë, dhe hiq.
Njohjen, dhe mosnjohjen, njoh.
Njoh molekulën e dritës, dhe dritën e molekulës.
Kam fytyrë dhe zverk.
Kam zverk dhe fytyrë.

Kam dashuruar
gjithë jetën,
dhe s'kam urryer asnjëherë.
Kam dashuruar shumëkend,
dhe s'më ka dashuruar kush.
Më ka dashuruar shumëkush,
dhe s'kam dashuruar kend.

Kam urryer gjithë jetën,
dhe s'më ka urryer kush.
Më kanë urryer gjithë jetën,
dhe s'kam urryer kend.
Kam qenë dashuria e shumëkujt, dhe e askujt.
Shumëkush ka qenë dashuria ime, dhe askush.
Kam miliona ëndrra,
dhe asnjë.
Jam ëndrra e shumëkujt, dhe e askujt.
Shumëkush është ëndrra ime, dhe asnjë.

Jam ikja e natës,
dhe ditëlindja.
Jam vetëshpërblimi,
dhe vetëdënimi.
Jam kujtesa, dhe harrimi.
Jam vetmia,
dhe shoqërimi.
Jam fundi, dhe fillimi.
Jam ikja, dhe kthimi.

Në natën time jam.
Në natën time,
Qeni i Qiejve,
u zhgënjye,
në flirtin me Hënën
e ftohtë.
Ai u kthye në shtrat,
ai e mbërtheu
Moshën e Shtratit,
fatin e tij, alias Venerën.

Por, ai, tashmë, fle,
e ndërkohë që ai fle,
unë jam bërë pritja.
Po pres.
Pas vetëm pak çastesh,
Venera do përvidhet nga Shtrati,
e do vijë ta tradhtojë, me mua.

A ha ha ha ha ha!...
Kujt do t'i besosh ti?
E di: askujt.
Ti do t'i besosh dritës.
Dritës që lind,
dhe dritës që vdes...

ÇASHTJE NJERËZORE...

Çashtje ashtë,
si me dijtë me i pasë
gjithnji me vete,
sytë e tu;

çashtje ashtë,
si me u ba lidhës
si kjo urë;

çashtje ashtë,
si me dijtë mos me qenë,
gjithnji, prej guri;

çashtje ashtë,
si me qenë paksa i rrjedhshëm
si ky lumë;

çashtje ashtë,
si me qenë paksa kokëulun,
paksa krahëvarun
si ky shelg;

çashtje ashtë,
si me qenë zaambël
si ai zog n'shelg;

çashtje ashtë,
si me qenë paksa i ndritshëm
si ky mëngjes;

çashtje ashtë,
si me dijtë me e dhanë
dritën tande t'paktë,
dhe si me dijtë me e shijue
dritën e shumtë
t'Zotit...

GJAKU I HËNËS

Sapozbrazur
gotën e shpërbërjes,
ecja mëdyshshëm,
pa ditur për kah.

E ndiqja hijen time
të dyzuar,
që si shtyllë e gjatë dykëmbëshe,
shtrihej e m'zgjatej
përpara meje.

Ndër dhëmbë,
pendueshëm mërmëroja
një dhembjekëngë dalldie.

Prapa krahësh,
lënë e kisha,
ikjen e pashmangshme,
nga thyerja, nga derdhja
e një zemre kristale.

Më mbetej prapa krahësh
edhe zëri këngëvajë
i një gjinkalle të largët,
që kushedi në qante a këndonte
për virgjërinë e humbur
në dehjen më të parë.

Ndër buzë mbaja
një lulemace të bardhë.

Nuk dija në shkoja
drejt kthimit t'agimtë
a drejt kasollës së asgjësë.

Nata,
si kompozitë tunduese,
e errët, e rëndë,
më rëndonte mbi krye.

Dehur, dehur, dehur,
e humba veten, toruan.
M'u morën mendtë,
m'u ngatërruan këmbët, rashë,
rashë dhe e pashë përmbysur,
fytyrën e përgjakur t'hënës
në një kanal fekalesh.

Oh, qava, qava,
për atë hënë!
Qava, qava, qava,
dhe e shkrova këtë vjershë
me gjakun e saj...

MITËR

Errësira qumështore -
ajo cepkë e vogël hapësie,
ku sapo nis bulimi
i vogëlsisë mishtore.

Është terrina lëngështore
e fillimit qeniesor,
ku sapoprovohet mezilëvizja e parë
e një palë këmbëve,
e një palë duarve indore.

Më e vogla vasionë
e dhembjes më të madhe,
ku me musht jete tharmohet
fija e hollë e një qafe,
që lidh një univers të ri,
me një trup të plogët,
të vdekshëm.

Zëvajshëm,
si gjithnjë,
del q'andej aksh fryma,
aksh qenia e mishtë
e terrdritës,
që vjen
për ta vuajtur veten,
me plotëni,
e përgjithnjë.

Del
përmes asaj plasurine të bekuar,
që errësirën qumështore
e lidh me botën -
parajsën më dritësore
të gjakut...

MUZIKA GJITHNJË MBARON...

Muzika gjithnjë mbaron,
secila këngë që dëgjon
është një frymë goje,

edhe mali
që shohin largas sytë e tu,
një çast i prishshëm është,

edhe qielli, edhe dita,
edhe ajo pemë
që t'shpërfaqet lakuriq
si stinë e largët,

edhe ajo turmë zogjsh
atje lart
që ik, ik, ik,

edhe mendimi yt
një zog a fekje është,
që shfaqet e humb,

beli i vashës flokëborë,
ku drita ka vënë duart tani,
nuk është i vërtetë,

një formë e dridhshme
e flujës
është ai bel,

e kuqja e buzëve
që sapo t'puthën
është një shenjë ere,
një tingull drite,
që do fiket pas pak,

merr frymë,
prek, shiko, dëgjo,
muzika gjithnjë mbaron,

secila këngë që dëgjon,
është një frymë goje...

TIRONA O E NONËS. PO KRYEQYTETI KUJT I PËRKET?

nga Fatbardh Amursi (Rustemi)



Portreti nga Ina Lajthia

Libri i fundit i Fevziut, "Tirona e Nonës", në tërësinë e tij: i shkruar bukur, me një intensitet emocional që përcillet në kohë reale, me një aftësi të admirueshme në portretizimin e protagonistëve të rrëfimeve, që kapin pragun historik të ngjarjeve, përfshi dhe befasitë e fatit, sa i hedhur në qiellin e shtatë apo i flakur në humnerë, ku aventura ndërthuret me kalvarin. Edhe nëse ti, me raste, shfaq mosdakortësi me autorin, mbresa nuk cënohet, vlerësimi nuk lëkundet, ndoshta dhe për faktin që, në këtë libër, gjen Blendi Fevziun e vërtetë, gjetiu i rrezikuar të keqkuptohet, edhe për fajin e tij. Një kronikë familjare, që i kapërcen kufijtë fisnor, ndonëse i paqtuar me idenë që, Tirona o e Nonës dhe ty s`të ndahet pyetja: po kryeqyteti kujt i përketë? Fevziu përmend një episodë, mund të rezultonte këmbërrëshqitës, kur gjimnazisti Blendi ngrihet në mësim dhe flet me gjuhën e Nonës: "Thashë që Tiranën e krijoi një pasha dhe më pas e zhvilloi një pasha tjetër, por kjo nuk ishte e vërtetë. Ishte mendësi e vjetër, më tha mësuesja e historisë. Tiranën e krijuan fshatarët dhe punëtorët, ndërsa e ringriti Partia pas Çlirimit." Në fakt, Tirona është më e hershme nga kryeqyteti i saj, atë e krijuan pashallarët dhe bejlerët, siç e thotë Blendi i Nonës, por në fund do t`i vinte zjarrin një katundar nga Sharra, Haxhi Qamili quhej, sikurse do ta bënte lëmsh edhe një Sude, pa folur për "çeçenët" e Bathores. Ndërsa historia e krijimit të kryeqytetit lidhet me Kongresin e Lushnjes, i cili po feston 100 vjetorin e tij. Fevziu, më parë ka shkruar dy libra, një për Enver Hoxhën dhe tjetrin për Ahmet Zogun, pa dyshim që mbreti e krijoi dhe komunisti e zhvilloi kryeqytetin, por Nona e Tironës nuk i honepste as "gegën" manarkist dhe as "tokskun" republikan. Të ardhurit e vrullshëm nuk gëzonin simpatinë e vendalinjëve të ngadaltë. Nona nuk e honepste shpurrën e injorante të mbretit, sikurse nuk i duronte pasanikët e rinj të biznesit, që fitonin shpejt. I shoqi i saj, Bajram Fevziu, ishte kundërshtar i Zogut, ndërsa i ati: "Refik Beu, pronar i madh tokash, nuk shkonte me Esad Pashën.", midis tyre kishte një konflikt në rritje. Refik Toptani do të shkruante dhe një libër për krimet e Toptanasve në fshatrat e Tiranës, të cilin e quajti *roman*. Ndoshta këto krime duhet të kenë nxitur dhe pakënaqësinë e fshatarëve, që i shkuan pas një të marri, i cili mbante një kubure me mulli, ku në njërën fole vinte fishekun dhe tjetrën në radhë e linte bosh. Kur ekzekutonet ndonjë "kaurr" para turmës, ia shkrepte armën me plumbin në gojë, pastaj e kalonte tytën në ballin e tij: "Qe Baba!"-arma nuk shkrepte ngaqë foleja e fishekut ishte bosh, kështu që turma e merrte për "të shenjtë". Nona e Tironës nuk donte: as Esat Pashë Toptanin nga Tirana, as dumbabën nga Sharra, as mbretin nga Mati, as komunistin nga Gjirokastra. Por, që të gjithë këta: lanë gjurmë në historinë e kryeqytetit. "Kishte kaluar më shumë se 50 vjet, por lagjja kishte mbetur si në ditët e para. Rezistenca e saj ishte e atillë dhe më duket se do të jetë e përjetshme; edhe sot është ende në vilat e vitëve `30, përkundër harlisjes së disa pallateve të shëmtuara, ndërtuar në vitet `90 dhe 2000."-shkruan autori, duke u bërë pjesë e nostalgjisë, mbase dhe i rezistencës ndaj presionit të kryeqytetit i dominuar prej të ardhurëve. "Ishte një lagje e ngritur dhe e ndërtuar vetëm në vitet e mbretërisë."-Në fakt, Tirona e Nonës, nuk ka të njëjtën moshë me kryeqytetin, përderisa e "krijoi një pasha dhe e zhvilloi një pasha tjetër", pasi Tirona dhe kryeqyteti kanë themeltarë të ndryshëm. "Ishte një lagje pa protagonizëm. Gjithkush jetonte brenda familjes dhe shtëpisë së tij, ndërsa plakat kishin vetëm një sfidë, lulet në oborr."-shkruan autori. Pra, një lagje e mbyllur, e përgatitur ndoshta dhe për kohën e izolimit apo të bunkerizimit. "Teta Meti mendonte se në vend që të urbanizohej, Tirana ishte ruralizuar.", pra, "fshati po rrethonte qytetin".

Tirona e vendalinjëve dhe kryeqyteti i të ardhurëve, Esat Pasha dhe Refik beu, pashallarët dhe dumbabët, ballafaqohen me një ta kaluar, që rasti e sjellë të shfaqet në një dialog midis dy motrave, duke qenë dhe shkaku kryesor i këtij shkrimi. "Teta Meti, motra e Nonës, ishte ndryshe. Më rrëfente për Karl Topinë, për Dukën Anzhu, dhe për lidhjen që kishin me ta. Nona nervosohej.

-Dukët t`i kam lënë ty,-i thoshte.-Unë kam nga Kapllan pasha dhe këndej....Kapllan Pasha nga Kruja është i pari i Toptanasve. Mos dëgjo teta Metin që thotë marrëzira.

-Ne jemi Topia më shumë. Këtë Toptani na i vunë Turqit, s`kemi lidhje me të, s`i kemi dash kurrë!" Më tej autori shkruan: "Kam bindjen se teta Meti, thellë-thellë, ndjehej mirë kur mendonte se kishte ende pak gjak francez në venat e saj." Nëse flasim për "kthim në identitet", cilën linjë duhet të ndjekim: atë të Nonës apo të teta Metit? (Dihet historia e Karl Topisë, princit me gjak francez, që, me sa duket ndolli Said Toptanin, të bëhej pjesë e revolucionin të vitit 1848 në Paris. Në atë Paris, ku do të vritej Esat Pashë Toptani dhe do të niste karierën politike Enver Hoxha. "Refik Toptani duhet të ketë qenë njeri vërtet i çuditshëm. Më vonë lexova se në vitin 1920 e hoqi mbiemrin Toptani dhe e quajti veten Refik Topia, duke iu referuar atyre, që i quante të parët e tij."-shkruan Fevziu i Nonës. Mos vallë tek Kapllan Pasha duhet të kërkojmë Tironën e Nonës dhe tek Karl Topia kryeqytetin e teta Metit? Kryqendra e Topiave ka për kryezot një Vrana Konti, një princ Leka. ("Iljaz Toptani mbante dhe titullin Kont, që sipas së bijës, ia dha Papa."-shkruan autori duke shtuar dozat e pëlqimit ndaj linjës së teta Metit.)

Nona ndjek "linjën e nënës", Advijes, që rridhte nga një familje e pasur Toptanase, e cila divorcohet nga i shoqi, për shkak të një shërbëtoreje. Në një variant thuhet se Rakip beu e dashuroi shërbëtoren dhe varianti tjetër se shërbyesja e sinjalizoi se e Advija donte ta helmonte. E shoqja detyrohet ta mbylli jetën në Stamboll, mbuluar me terr dhe mjegull, sikurse dhe i shoqi i përndjekur nga hyzmeqari i tij, Haxhi Zjarrmi, arratiset për në Vjenë. Është teta Meti, që ndjek "linjën e babit", Refikut, për të cilin një studjues francez, shkruan: "Ndër gjithë Toptanasit, që janë sot afro 50 familje, Refik Toptani është më i hapuri ndaj çështjeve të jashtme për Shqipërinë dhe njohësi më i mirë i tyre, pasi ka udhëtuar shpesh për në Evropë." Ai sjell në Tiranë makinën e parë Ford. Nëse do të kërkonim identitetin e "Tironës së Nonës", autori do na afronte këtë mjedis, që përkon me "linjën e nënës", atë allaturka: "Kur e kujtoj, më ngjan me një minilagje e Perandorisë osmane. Pleqtë flisnin më shumë fjalë turqisht. Edhe sot më kujtohen disa fraza që në atë kohë ngjanin aq të zakonshme.-Ho me si je? S`kom pa ka hone? Mirë bereqavers, ejvallah!-Mos u qell në aksham! -Të çoj selam!" Po ajo Turqi, ku kish zgjedhur të jetonte e ëma e Nonës, Advija. Habia shtohet, kur gjyshja e Fevziut, Lisi, lindur dhe rritur në këtë "minilagje të Perandorisë Osmane", teksa kthehet pas 35 vjetësh nga Nju Jorku, vë duart në kokë e skandalizuar: "Si mund të jetojë njeriu gjithë jetën në të njëjtën shtëpi dhe në të njëjtën dhomë? As ngjyra e mureve nuk ka ndryshuar!" Është fjala për Tironën e Nonës, krejt allaturka. Arsyen pse ndodh kështu më duket se e ka pikasur Fatos Lubonja, i cili në ditarin e tij të burgut, shkruan: "Ky qytet s`mund të ngrihet kurrë në demonstratë për të kërkuar liri,-thashë vetmevete,-një qytet individësh të vegjël e të përndarë që s`mund të bashkohen kurrë për punëra të mëdha. Gratë do të luftojnë për ndonjë pallto më elegante dhe kaq, kurse burrat për ndonjë grua të bukur dhe kaq." Pra, një qytet, ku banorët kanë qëllime të limituara, ku nëna merr për nga Stambolli dhe babai për nga Vjena. Kjo është arratia e protagoniztëve. Aktualisht, mos kemi një Tironë, që vazhdon të jetojë në Kapllan Pashës dhe një kryeqytet, që ende s`e ka gjetur Karl Topinën? "Kur mbërriti në Tiranë në vitin 1991, e veshur me një *jumper* të bardhë, me sandale dhe çantë të kuqe, shumë nga fisi u skandalizuan. Dajë Aliu që ia mbante mërinë që nga ikja, i tha Lisit se duhet të kujtonte se ishte 65 vjeçe tani, duhej të vishej ndryshe... "Si të vishem? Si ju? Të gjithë njësoj?" Kur shoqet i thonë se gjithë Tirana e kishte marrë vesh ardhjen e saj dhe po fliste për të, ajo ia kthen e habitur: "-E ç`punë ka Tirana me mua?! Ju paskeni mbetur njësoj, s`paska ndryshu asgjë!" Enver Hoxha ndryshoi mjedisin, por jo fisin. Kryeqyteti nuk qe allaturka, por nuk u bë as allafrenga, as Lindje dhe as Perëndim?! Sa duhet të vazhdojmë me këtë mëdyshje?

Siç dihet, 4 djemtë e Kapllan Pashës nga Kruja, martohen me 4 vajzat e Sulejman beut nga Tirana, s`di pse krekosen me lartësimin e "oxhakut" të Toptanasve, kur janë thjesht në pozitën e kollovarit? Fevziu, duhet ta ketë përllogaritur, në mos i ka dalë rastësisht, që Tirona e Nonës, shpreh dhe pronësinë femrore të sajën. Edhe vet autori, edukimin e tij, ia njeh tri nonave, ku e ëma, Rezana, shfaqet e largët, ndoshta dhe si një reagim instiktiv ndaj "nënës parti", e cila i quante të gjithë bijtë e saj, përjashto pinjollët e Nonës. Ishte pikërisht e veja e Zogut I dhe e veja e Sekretarit të Parë, që do ta ngrysnin jetën në kryeqytetin e burrave të tyre, ku njëri e themeloi dhe tjetri e zhvilloi kryeqytetin, duke mos e larguar pashanë nga shpirti. (Nëse Nona nuk e honepste Zogun I, plaka e tretë në radhë, Bibia, shfaq njëlloj konsiderate për Sekretarin e Parë: "U biiir Enveri, djalë i urtë dhe i sjellshëm!", e cila njihet edhe Nexhmijen. "Lika Toptani u kishte dhënë qese të tëra me flori komunistëve, kryesisht Ramiz Alisë, të cilin e kishte shok." Ndërsa gjyshi i Blendit, Ali Ypi, kryeagronom në fermën e Lushnjes, kishte njohje me Mehmet Shehun dhe Hysni Kapon, por nuk pati asnjë dëshirë t`u afrohej njerëzve të regjimit.) Protagonizmi politik i Toptanasve u shfaq i tëri në krahun e Esat Pashë Toptanit, të cilin mbreti Zog e zgjodhi si shëmbëlltyrë të vetin, sikurse Sekretari i Parë pati për model Zogun I. Kryeqyteti ishte produkt i tyre, ku në themel, si për Tironën e Nonës, mbetet përsëri pashai. Nëse i jati i Nonës ishte kundërshtar i Esat pashës, i shoqi i saj, Bajram Fevziu, njihet si kundërshtar i Naltmadhënisë, amaneti i të cilit ishte: "Nigjar, nëse është djalë, amanet të mos merret kurrë me politikë. Edhe sikur karrocier të bëhet më mirë se sa të merret me politikë." Tirona e Nonës, ndryshe nga kryeqyteti, i ndenji larg politikës.

Fevziu ka të drejtë, kur thotë: "Komunizmi dukej se i kishte trëmbur të gjithë." Ish-kryeministri komunist, Shehu, ankohej se i përgjonin telefonin. "Më habiti frika që parandjente ajo (Nexhmije Hoxha), se një ditë mund të jepte llogari për trajtimet e privilegjuara mjekësore... Nuk e saktësoja dot se prej kujt ruhej ajo se do të duhej të jepte llogari? Ndaj popullit? Partisë? Apo personalisht ndaj Enverit?"-Isuf Kalo "Blloku". "Shoku Pilo ishte shumë i shqetësuar, sepse unë e paskam shikuar shtrembër, prandaj vuri pyetjen ç'ka dhe ç'dyshon për mua shoku Enver? Unë jam i poshtër, borgjez, thotë ai, se kur ka bërë autobiografinë, nga turpi, paska fshehur faktin që ka qenë

në Itali dhe në Greqi me të shoqen dhe ca më vonë kur ka shkuar pas çlirimit në Francë ka shpenzuar disa franga franceze të tepërta, të cilat nuk i ka shlyer. Tha gjithashtu se kishte bërë edhe disa poshtërsira të tjera me femra etj. Mos vallë shoku Enver kish marrë ndonjë raport nga poshtë kundër meje, sepse nga njëherë, kur kam qenë në Dhërmi e gjetkë, flisja ndonjë fjalë greqisht?!" Frika, e ka epiqendrën në kryeqytet. Gjermanët masakrën e bën në Borovë, ndërsa Xhaferr Deva 4 Shkurtin e bëri në Tiranë. Një kryeqytet: paradash, mitingjesh dhe foltoresh. Dikur një kryeqytet paranojakësh, sikurse sot një qytet mitomanësh.

"Komunizmi i shpalli luftë të heshtur kafeneve." -thotë Fevziu, thua se po zbulon shkakun e anormaliteti, ndërsa Kadare për kryeqytetin e shekullit të ri në poemën "Tirana në dimër", shkruan: *"Në kafene ka për çdo punë një qasje,/Të tillë që kurrkënd nuk e gjen dot./ Për tri mijë euro porosit një vrasje,/Për katër mijë, titullin vikont."* Ndërsa Gjergj Bubani për kryeqytetin e viteve `30, do shkruante: "Më tej në një godinë moderne ishte "Kursali", mbushur me burra, ku e vetmja femër, ishte italianja Marçela, që shërbente si kamariere. "-Sikur të mos ishte Marçela, "Kursali" do më dukej si një vend pederastësh!"-do i thoshte Milto Sotir Gurra.-Gazetat këtu u përngjasin temjanicave të priftërinjëve." Nuk po komentoj se Fevziu e kap aktualitetin e temjanicës.

Fevziu u rrit në një shtëpi, ku porta hapej rrallë dhe dera ishte më e heshtura e lagjes. Si është e mundur, nga një shtëpi e mbyllur, nga një lagje pa protagonizëm dhe nga një vend i bunkerizuar, tek pinjolli i Nonës lindi ndjenja e aventurës për të shëtitur botën? "Unë isha më i pazoti në lagje për të bërë ballona." dhe pikërisht ky, i bie kryq e tërthor botës duke i hipur ballonës?! Shpjegimi i tij se po përmbush një amanet të Nonës, nuk më duket bindës, pasi është diçka tjetër, që e thërret si kushtrim të parësh: "Sapo të hapet një shteg, ikni. Shqipëria nuk bëhet. Në botë ka vende që bëhen dhe që nuk bëhen. Ne nuk bëhemi!"-i thotë Nona. Të njëjtin amanet përcjellë dhe autori tek vajzat e tij: të ikin. (Në emisionin "Opinion" ankohet për braktisje të atdheut?!) Sidroma e ikjes, vjen prej hershmërisë sonë me: piratë, mercenarë, cuba, nizamë, kurbetlinjë, të arratisur politikë, aventurierë, por dhe i shpërnguljeve prej tragjedive kombëtare, sikurse kanë qenë pushtuesit. Shto dhe karierizmin apo ambicjen e shqiptarit për të bërë emër në botë. Hobi i Fevziut për udhëtime, 110 shtet ka vizituar deri tani, duke ia kaluar dhe gjyshes së tij, Lisit, me banim në Nju Jorku, me 96 shtete, por jo vëllait të saj, Iljaz Toptanit: jetuar dhe udhëtuar në 236 vende, pa përmendur paraardhës të tjerë, nuk ka të bëjë me kryeqytetin, por me Titonën e Nonës, themeluesi i së cilës është një jeniçer, që u shpërblye nga sulltani për shërbimet, që ai kishte bërë ndaj tij. Në historinë e Shqipërisë kallogreja dhe gjeraqina, janë alternuar shpesh mes tyre, sikurse Kadare shkruan për ikjen e Moisi Golemit, edhe pse qortues, merr arratinë për në Francë: "Qindra vjet shkuan,/Ti lëviz si ankth./ Dimëron në qiej,/Por dheu s`të qas." Ndërsa Naimi ngazëllehet për kthimin e Skënderbeut, duke mos lëvizur nga Stambolli: "Krujë, o qytyet i bekur, prite, prite Skënderbeun!" Nëse kthehet një Gjergj Kastrioti, nuk ndihet ikja e Moisi Golemit. Në këtë ik e jake përfshihemi të gjithë, ndaj dhe Tirona mbetet e Toptanëve, ndërsa kryeqyteti shpresojmë "t`i kthehet" Topijave, duke shpresuar se ai pak gjak francëzi që rrithte në damarët e Karl Topisë, do i vlejë Makronit, që siç dekoroi shkrimtarin Kadare, të firmos pro hapjes së negociatave të Shqipërisë për në BE.

Libri i shkruar për Nonën, i tretur natyrshëm brenda tij, krahasuar me librat jo fort të përtypshëm, si për Zogun I dhe Sekretarin e Parë, "Tirona e Nonës" më bindi se Fevziu, është i zoti në fusha me porta të vogla dhe jo në fushë të madhe, tek kronikat dhe jo tek hapsirat e pafundme të historisë me plot hyçkla, në labirinthe arkivash, sikurse ia arrin, Ilir Ikonomi, që ka shkruar për figura tejet të ndërlikuara, si ajo e Faik Konicës dhe Esat Pashë Toptanit. Bindjen time po e konkretizoj. Në libër shkruhet: "Bibija tregonte një histori, që asnjëherë s`e kam kuptuar se sa e vërtetë ka qenë. Mehmet Konica, pas shumë përpjekjesh që kërkonte takim me Lordon Grey, ministrin e Jashtëm të Britanisë, për kufijtë e Shqipërisë, ia arriti 5 minuta audiencë... i cili po e priste duke parë nga dritaria thuajse me shpinë.

-Sër, nuk kam ardhur për asgjë tjetër, veçse t`u them që në Shqipëri sapo është zbuluar një minierë e madhe ari." Grey e braktisi dritaren, u përqendrua dhe e pa në sy. Natyrisht që nuk ishte një minierë e vërtetë, por e vetmja mënyrë për të tërhequr vëmendjen e ministrit britanikë. Jam munduar ta gjej këtë fakt më pas në kujtimet e bashkëkohësve apo tekstet e historisë, por nuk më rezulton askund. Mund të jetë me gjasë, një prej legjendave që u krijua më vonë." Të gjitha janë thënë gabim. E ka patur rastin, ta gjente dhe faktin e dëshiruar, ngaqë përmend në libër vizitën e Julian Amery, pas 50 vjetësh, në shtëpinë e Bibisë, i cili si xhentelmen i vërtetë i lë asaj në tavolinë një kuti me çokollata, një me biskota dhe një pako çaj. Sikur të kishte lënë dhe librin e tij "Bijtë e shqipes" kushtuar Abaz Kupit, Fevziu do lexonte këtë paragraf: "Në njërën nga konferencat e shumta ndërkombëtare, që u mbajtën pas Luftës së Parë Botërore, Shqipëria ishte përfaqësuar nga Faik bej Konica (jo Mehmet Konica), një njeri mendjehollë dhe shumë i shquar. Faik beut i duhej siguruar përkrahja britanike në lidhje me kërkesat e vendit të tij dhe, pas shumë përpjekjeve të pasuksesshme, iu afrua më në fund, jo pa hezitim një bashkëbisedim më Lordin Kërzon (jo Lordin Grey). Kërzon e priti Faikun duke qenë i ulur dhe në mënyrë të ftohtë, kërkoi që të mos zgjatej në ekspozenë e tij. Delegati shqiptar bëri një referencë dhe ia nisi: "Shkëlqesë, në Shqipëri ka vajguri.(jo ar)" Sytë e Kërzonit filluan të shkëlqejnë: "Uluni, i dashur mik!"-i tha duke u ngritur përnjëherësh dhe për çudinë e sekretarëve të padurueshëm, biseda u zgjat më tepër se një orë.(jo 5 minuta)" Kjo është arsyeja që konsulli anglez Eden u tregua shumë aktiv në mbajtjen e Kongresit të Lushnjës, i cili binte më shumë era naftë se sa barut. Nuk di pse historiografia jonë i kalon anash këtij zhvillimi, duke i mëshuar vetëm patriotizmit? Sikurse është jashtë vëmendjes së saj dhe vizita e konsullit amerikan në Torino, Jozef Haven, i cili u prit si shpëtimtar në disa qytete të vendit tonë, në prag të mbajtjes së Kongresit të Lushnjes, e përsëritur kjo pritje shumë vite me vonë me sekretarin Bejker në Tiranë. Në raportin dërguar Uashingtonit, Haven, shfaqi mendimin se Shqipëria është një vend që qeveriset vetë, sepse i ka të gjitha elementet e duhura që nevojiten për një vetqeverisje. Jemi në kohën kur doktrina e Uillsonit për vetvendosjen e popujve i hodhi diplomatët evropianë në një terren krejtësisht të panjohur për ta. Amerika nuk ndjeu erën e naftës, por të lirisë.

Teksa lexoja librin e Fevziut, më vëllazëroheshin idetë, ku spuntot nxitëse bëjnë të vetën dhe kënaqësia e leximit të kthehet në një dëshirë për të shkruar, sikurse ndodh me transformimin e energjisë elektrike në atë mekanike. Por, me sa duket, edhe tek unë: rrinte i fshehur një obligim, njëlloj borxhi që, një shkrimtari: nuk i lejohet, të mos e shlyejë, sikurse ia kërkon lartësia e të qënit shpirtëror. Kur fillova për herë të parë punë në Çermë të Lushnjes, si mësues letërsie, zëvendësova të jatin e Blendit, Hektor Bregasin, i cili u transferua në Dushk, fillimisht si roje objekti dhe më pas si llogaritar. Hektori, imponohej më shumë me hijen prej intelektuali, se sa me të qënit kryeqytetas, që, për atë kohë shfaqej, si njëlloj kapadaillëku. E ëma e Fevziut, Rezana, sikurse motra e saj, Elga, u mbajtën mend gjatë në Lushnje, më shumë nga Lisi e sapokthyer nga Nju Jorku, që paska çuditur Tiranën. Të jatin e vajzave, kryeagronomin Ali Ypi, e kam parë veçse njësoj: mbi motor, duke krijuar idenë e njeriut, që kishte harruar të ecte. Familja e Ypëve, ishte pjesë e një komuniteti të ardhurish, që i bën veçse mirë qytetit tim, i cili e ka për mburrje, t`u krijojë lehtësira të ardhurëve. Me të vetët sillej ndryshe: nëse dikush kërkohej në Tiranë, i pengohej kariera me një shkresë përcjellëse: kemi nevojë për kuadro. Nuk mund të mos kujtoja, mësuesen e gjeografisë, Flutura Lezo, që të gjithë e merrnin për të jashtme. Ajo ishte një femër e lirë, ndoshta ngaqë flitej aq shumë për të. Mësuesen e fillores, Tajbe Turdiu, bashkëshortja e profesorit të gjimnazit, Ismail Turdiu, ku historia e krushqisë së Turdinjëve me ish kryministrin Shehu, pati kostot e veta dhe tek ata. Po kështu, mësuesen e 7 vjeçares, Marie Guga, me familjarë të arratisur, bashkëshortja e profesorit të matematikës, Mite Guga, i cili, teksa na përgatiste për provimet e pjekurisë, në vend të kompasit që nuk po ndodhej për momentin, e bëri rrethin në dërrasë me rripin e fustanit të së shoqes. Marcela e permanentit të vetëm të qytetit, ku gratë dridhnin flokët, e ardhur me dënim për shkak të të shoqit, drejtori i parë i kinostudjos "Shqipëria e re", Nesti Zoto, i cili tentoi të vetëvritej duke prerë damarët. Doktoreshë Manushaqen e kryeinxhinierit Mërgim Korça, e cila sa herë do kalonte pranë portës sonë, do kthente për të mbushur duart me trandafila. Regjisorja e parë femër, Myzejene Nepravishta. Nuk mund të mos kujtoja moshataret e brezit tim: Xhixhin dhe Klarën e doktor Hilmi Deliallisit, me veprimtarë të njohur në historinë tonë, me Mimin dhe Gordanën e doktor Qirjako Lezhos me vëlla të pushkatuar, sikurse Rezana Jukën, të cilën herë e merrnim si pasardhëse të "Heroinës së popullit" Shenjaze Juka dhe herë të ministrit të Zogut, Musa Juka, në fakt ishe e bija e Zyber Jukës specialistit të kultivimit të pambukut, po kështu dhe Safete Libohovën, që ndonëse dëshmorin Skënder Libohova e kishte xhaxha, i llogaritej dënimi i të atit, po kështu motrat Lora, Liria të gjeneral Nexhip Vinçanit, i cili i la vajzat me nënën duke u martuar me një grua të dyte, por la amanet të varrosej me Memkën e vajzave, Eva Mëhillin me baba të burgosur nga regjimi, por që njihej më shumë si vajza e mësueses sonë, Liri Kazazi, që në fakt ishte tezja e saj. Eva së bashku me të motrën, frekuentonin rregullisht ndeshjet e futbollit në stadium. Po kështu dhe Erikën, vajzën e doktor Ihsan Çabejt, të cilin, kur e qarkulluan në fshat, hallexhinjtë i shkuan pas dhe, autoritetet u detyruan, ta kthenin përsëri në spitalin e qytetit. Ishte njolla në biografi, që i kishin sjellë në Lushnje, por, ajo kurrë nuk u kthye në damkë. Asnjëherë nuk i pashë vrarali, ankimtarë, vesveselinjë, por, veçse rrezatues energjish pozitive. Nuk shfaqnin modë, i rrinin larg modernes, pasi me to rrezikonin, por u ndihej sqima, klasi. Nuk di ndonjë qytet tjetër në botë, ku pak femra, njëra më e bukur nga tjetra, sikurse dhe pak intelektualë me peshë, të sjellë me përdhunë në provincë: të gjeneronin hijeshi, mirësi, çiltërsi, dinjitet. Meqë "Kongresi i Lushnjes" u bë sebep i shpalljes së kryeqytetit, dhe në rrugët e qyteti shoh të afishuara portrete të personazhëve historik, s`kisha rast më të përshtatshëm të shkruaja për këto vajza, gra dhe burra, që ndikuan në qytetin tim pozitivish, duke marr shkas dhe nga "Tirona e Nonës", e cila mbyllej në vetvete, pa protagonizëm, nën trysninë e kryeqytetit, që e mori udhën nga Lushnja.



PËR OSCAR WILDE-IN DHE PLAGJIARIZMIN

nga Joseph Bristow, Rebecca N. Mitchell

Shumë i vlerësuar për inteligjencën e jashtëzakonshme dhe risuese, Oscar Wilde dhe nocioni i origjinalitetit rëndom përbëjnë një dyshe të pandarë. Kjo dyshe, sidoqoftë, nuk është pa probleme. Joseph Bristow dhe Rebecca N. Mitchell shqyrtojnë pretendimet për plagjiarizëm që e kanë shoqëruar gjithmonë karrierën e Wilde-it, sidomos për fijet lidhëse me veprën e personalitetit tjetër të shquar të dekadentizmit (estetizmit) të fundit të shekullit të 19-të, piktorin James MecNeill Whistler.

Akuzat ndaj Oscar Wilde-it për plagjiaturë sigurisht nuk janë të reja. Ato e kanë origjinën e tyre në kritikat e ashpra të bashkëkohësve për vëllimin e tij të parë të botuar, "Poezi" (1881). Edhe nëse nuk u pohua se ndonjëra nga poezitë ishte vjedhur fjalë për fjalë nga Romantikët dhe Para-Rafaelitët, veprat e të cilëve ai i adhuronte, kritikët kuptuan se pjesa më e madhe e veprës ishte shumë imituese. Revista e përjavshme "Saturday Review" jep një shembull të mjaftueshëm se si u prit libri nga kritika: "Libri nuk është pa gjurmë zgjuarsie, por humbet nga prania kudo e imitimit, mungesës së sinqeritetit dhe shija e keqe letrare".[2] Në të njëjtën kohë, është fakt i njohur që "Unioni studentor i Oksfordit" e refuzoi kopjen e vetme të "Poezi" që sekretari i saj i kishte marrë Wilde-it, pasi në një nga forumet e debatit të "Unionit" studenti Oliver Elton, i cili më pas do të bëhej një historian i famshëm i letërsisë, tha se poezitë e Wilde-it "nuk dukeshin të krijuara prej tij, por nga disa autorë shumë më të njohur dhe me autoritetet të merituar.[3] Studiues modernë kanë hedhur poshtë herë pas here pretendimin e Elton-it, duke nënkuptuar se përçmimi për zërin poetik të Wilde-it i cili ishte duke u krijuar apo qoftë edhe thjesht xhelozia e mirëfilltë ishin motivet e kësaj proteste publike.[4] Sidoqoftë, damka e vënë pas botimit të "Poezi" ka mbetur aty për këtë vepër poetike ashtu si dhe për shumë të tjera pjesë e opusit krijues të Wilde-it.

Në fund të shekullit të njëzetë, mungesën e hamendësuar të origjinalitetit një studiues e shihte si shenjë të përtacisë së tij të lindur: "Ke vetvetiu përshtypjen se Wilde tregon papjekuri të pazakontë në procesin e rikrijimit të modeleve të larmishme dhe të papërvetësuara poetike. Të bën ta humbasësh durimin refuzimi i tij prej dembeli për ta zëvendësuar shkrimin me shkurtime me një frazë të mirëmenduar me kujdes, dhe po kështu të trondit paturpësia e një mashtruesi të mundshëm letrar.[5] Shumë studiues nuk e kanë marrë parasysh idenë se identifikimi i Wilde-it me idhujt e tij të epokës Romantike dhe Para-Rafaelite ishte kaq i fortë sa përkushtimi i tij për ta dhe jo dëshira për t'i vjedhur, çoi në kopjimin e dukshëm të shkrimeve të tyre. Dhe filli përbashkues mbetet fakti se, ndërsa akuzat për këtë shtirje përligjeshin nga stërhollimi estetik i Wilde-it, duket se pak ishin ata që e morën seriozisht idenë që mungesa e vullnetit apo moskokëçarja që ai mishëronte ishte në vetvete shtiracake; qëndrimi shpërfillës (ashtu si diplomimi për të njëjtën fushë studimi "letërsinë klasike" në "Trinity College" në Dublin dhe pastaj në universitetin e Oksfordit, duke këmbëngulur madje para shokëve se do të ishte me fat nëse nuk merrte një tjetër diplomë për të njëjtën gjë për herë të tretë) ishin fryt i një përpjekjeje të pareshtur dhe të maskuar me mjeshtëri.

Që nga fillimi i viteve 1880, Wilde e kishte të vështirë të çlirohej nga besimi i ngulitur se ai përvetësonte me kënaqësinë më të madhe idetë e të tjerëve. Deri tani, konflikti më i disutueshëm gjatë karrierës së Wilde-it lindi nga kritikat që piktori konkurues në aspektin shoqëror James McNeill Whitsler bëri për përvetësimin e hapur por të papranuar të thënieve të tij.

Rivaliteti midis artistit më të vjetër amerikan dhe autorit më të ri irlandez, të cilin e shihje në rrethe të ngjashme në mode asokohe, u zhvillua nëpërmjet një polemike të nxehtë, për të mos thënë të ashpër në shtypin periodik. Në 20 shkurt, 1885, Whistler mbajti ligjëratën famëkeqe "Leksioni i orës dhjetë", titulli i së cilës tregonte se për të tërhequr vëmendjen kishte zgjedhur orën dhjetë të mbrëmjes si koha e përshtatshme për të folur për artin. Whistler-i sulmoi veçanërisht kritikun modern: "shkrimtarin e pavarur" i cili "është kthyer në sekser i çështjeve të Artit"[6] Një gjyqtar i tillë i shijes, sipas pikëpamjes së Whistler-it, nuk mund ta shihte poezinë e "*piktorit*" në një vepër arti, sepse kritiku e sheh atë njësoj siç do të shihte një roman, një histori apo një rëfenjë zbavitëse."[7]

Wilde iu kundërpërgjigj duke e kundërshtuar besimin e Whistler-it se vetëm artisti mund ta kuptojë bukurinë estetike. "Artisti" komentoi Wilde, "nuk përbën një fakt të izoluar; ai është tërësia e një mjedisi të caktuar, e një rrethi të caktuar shoqëror, dhe nuk mund të lindë nga një komb që i mungon çdo ndjenjë e të bukurës sikurse një gjemb del nga trëndafili. Me fjalë të tjera, Wilde deklaronte se tradita kulturore krijonte kushtet në të cilat mund të lulëzonin llojet më të përsosura të artit. Përveç kësaj, ai pohoi se në kohët moderne, "artisti e gjen të bukurën tek e shëmtuara, *le beau dans l'horrible*."[9] I sfiduar, Whistler reagoi menjëherë tek "*World*", duke thënë se Wilde nënkuptonte që ishte detyrë e poetëve modernë të gjenin "të shëmtuarën tek e bukura" (*l'horrible' dans 'le beau*".[10] Nga ana tjetër, Wilde iu kundërpërgjigj që Whistler-i pak kishte kuptuar nga kritika e tij "Kësaj radhe po të paralajmëroj, James dhe bëj sikur unë, ji i pakuptueshëm. Të jesh i madh do të thotë të keqkuptohesh."[11] Me qesëndi të qëllimshme, në rreshtin e fundit Wilde theksoi atë që donte të thoshte duke cituar, megjithëse nuk e përmend qartë, esenë e famshme të Emersonit, "Vetëbesimi" (1840)[12], duke përvetësuar mençurinë e dikujt tjetër për të folur në mënyrë të përsosur në emër të tij.

Afër fundit të vitit 1886, Whistler-i u nxeh përsëri

kur zbuloi përvetësimin fare hapur të disa prej thënieve të tij. "Çfarë ka Oscar-i të përbashkët me Artin përveçse ha darkë në tryezat tona, dhe merr nga pjatanca kumbulla për ëmbëlsirat që ai shet si shitës ambulant në periferi."[13] "Oscar," vazhdon thumbimi i Whistler-it, "ka guximin të ketë të vetat pikëpamjet…e të tjerëve!"[14]

Çështja nuk u mbyll këtu. Vite më vonë, piktori amerikan përsëri bëri zhurmë në media pasi lexoi kujtimet e Herbert Vivian-it, të botuara në gazetën e Londrës "Sun" në vjeshtën e vitit 1889. Vivian sillte ndërmend një leksion që Wilde kishte dhënë afërsisht shtatë vjet më parë, për të cilin Whistler-i "për hir të miqësisë e kishte ndriçuar plotësisht për temën". Gjatë këtij leksioni, Wilde në mënyrë ironike e kishte quajtur Whistler-in "Flutura" (Ai i nënshkruante veprat e artit me një flutur të stilizuar) dhe kishte ligjëruar gjëra të thëna prej tij pa ia njohur autorësinë.[15] Vivian-i gjithashtu vinte në dukje se tek eseja "Rrënimi i gënjeshtrës", botuar në revistën "Nineteenth Century" në janar 1889, Wilde kishte përfshirë, pa e përmendur Whistler-in si burim, synimin e artistit "që ka guximin për të patur të vetat…pikëpamjet e të tjerëve".[16] Fyerja e pretenduar se ka bërë Wilde ndodh më herët në ese, kur folësi kryesor në këtë dialog kritik argumenton që romancieri modern ka humbur aftësinë për të gënjyer dhe thjesht "na paraqet fakte të rëndomta nën maskën e krijimit letrar": Ai nuk ka as guximin e të pasurit të ideve të të tjerëve, por këmbëngul që duhet të shkosh tek jeta për gjithçka, dhe në fund të fundit, i ndodhur mes enciklopedive dhe përvojës vetjake, ai kthehet në jetën reale, dhe pasi ka vizatuar tipat e tij të marrë nga rrethi familjar ose nga rrobalarëset e pastrimit kimik, bëhet rob i një informacioni prej të cilit asnjëherë, as në çastet më përsiatëse, nuk mund të çlirohet plotësisht.[17]

Në sytë e Whistler-it, ironia nuk mund të ishte më e mprehtë se kaq. Në këndvështrimin e tij, Wilde vështirë se mund të provonte origjinalitetin artistik në roman kur kritika e tij ndaj një krijimi letrar kaq përsëritës dhe të parashikueshëm mbështetej tek fjalët që kishte vjedhur nga mjeshtri i tij i mëparshëm: Whistler-i vetë. Ai shkoi aq larg sa ta quante Wilde-in "kryemashtruesin" keqbërës, "plagjiatorin e zbuluar", dhe "plagjiatorin e gjithçkaje", dikush që në Amerikë do të ishte dhunues i ligjit.[18] Megjithatë, për Wilde-in, "të bërtiturat e zhurmshme për plagjiarizëm" të Whistler-it ishin shenjë për të ardhur keq e "kotësisë idiote ose e mediokritetit që ka i paafti".[19]

Pavarësisht se sa të rëndomta mund të ngjajnë ankesat e Whistler-it, ato hedhin dritë në vështirësitë që dalin në paraqitjen e Wilde-it në rolin e një plagjiatori mashtrues. Whistler-i e përshkroi ftesën e tij për darkë si një lloj "dendje", duke e quajtur një ditë e zakonshme pune e mësuesit me një më të ri në zanat, duke shtruar pyetje që kërkonin përgjigje për lidhjen mes pedagogjisë dhe plagjiarizmit: A mundet mësuesi ta akuzojë studentin e tij për këtë krim ngaqë nxënësi ka riprodhuar mekanikisht përmbajtjen e mësimit? A nuk është qëllimi i nxënësit, kur përgatitet pareshtur për një provim, zhvillimi i aftësisë për të riprodhuar me besnikërinë më të madhe të mundshme informacionin e studiuar?

E parë me sy kritik, akuza duke mburrur veten ndaj Wilde-it mund të ngjajë fare mirë si shfajësim për të sajuar me vendosmëri një armiqësi mediatike, të tillë që Whistler-i ta shfrytëzonte për të qenë në qendër të vëmendjes së publikut. Megjithatë, fyerjet e tij e ndihmuan në ruajtjen e shumë pretendimeve që mendja e Wilde-it nuk tregonte origjinalitet. Shumë më vonë, Frank Harris, i cili krijoi një marrëdhënie të ngushtë me Wilde si botues dhe mik, përsëriti besimin që Whistler-i kishte ndikuar për ta formësuar aftësinë e jashtëzakonshme të tij më shumë se çdo personalitet tjetër: "Ndër të gjitha ndikimet nga personalitet që formësuan talentin e Oscar Wilde-it, ai i Whistler-it është nga sa dimë deri tani, më i rëndësishmi. Ai i mësoi vlerën e inteligjencës së jashtëzakonshme dhe të fuqisë që lind nga të qenit i vetëdijshëm për aftësitë gjeniale që ka njeriu me dhuntinë e lindur të artistit." Sipas pikëpamjes së Harris-it, Wilde pati sukses të madh si shkrimtar për shkak të "aftësisë së shkëqyer" ashtu si dhe të "krenarisë tepër të madhe" - cilësi që duket se asnjë akuzë për plagjiarizëm nuk mund t'i ndrydhë.[20]

Ky sukses nuk i krijoi Wilde-it imunitet nga pretendimet se vepra e tij nuk ishte origjinale. Në fillim të vitit 1892, kur komedia e tij më e hershme shoqërore, "Freskorja e Ledi Uindermir", mori shumë duartrokitjee në teatrin e St. James-it, huazimet e dukshme i trazuan sërish kritikët. Kritiku deri diku liberal A. B. Walkley, për shembull,

Oscar Wilde dhe Whistler, imazh nga lapsi i Phil May, 1894. Në diçiturë shkruhet: "Ishte tmerrësisht [vërejte me vend] shakaja që the mbrëmë. Do të doja [ta kisha thënë unë] dhe të thosha se është e imja. "Këtë do bësh, i dashur djalosh. Këtë do të bësh.

pohoi "vijimësinë e ndodhive" që buronin "nga një dyzinë dramash franceze", dhe vërejti që potagonistja femër ishte "një nuse e re e padjallëzuar" e cila i shëmbëllente "dramës "*Françillon"të* Aleksandër Dumasit".[21] Ndërkohë, për aq sa ai mund të thoshte, një personazh tjetër i Wilde-it, zonjusha Erlynne, ngjante se kishte dalë nga një dramë tjetër e Dumas "Fils, L'Étrangère" (1876). Diku tjetër, sipas një kritiku drama dukej se "ishte një përzierje jo pak gjeniale e dramës "Eden" të Edgar Saltus-it, me "Idler" të Haddon Chambers-it," bashkë me atë dramën tjetër të mirë-njohur të kurorëshkeljes, "Fran*çillon*" (1887), të bëra njësh mirë e bukur.[22] Jo të gjithë mendonin se kjo përbënte veprim të dënueshëm. Siç e perceptonte çështjen Frederick Wedmore, huazime të tilla ishin teknika standarde në teatër, koment i mbështetur nga numri i dukshëm i teksteve të përmendura si burime për dramën e Wilde-it. Sipas këndvështrimit të tij, edhe nëse "Freskorja" – dramë e rëndësishme e vënë në skenë kishte një paraardhëse të qartë tek "Idler" (1890) e Haddon-it, kjo "zor…se bën edhe më pak inteligjentin të nënkuptojë plagjiarizëm".[23]

Në posterin e dramës "Freskorja e Ledi Undermir", shkruhej për një "dramë të re dhe origjinale". Si mund të kenë kuptim atëherë këto huazime?

Me kalimin e viteve, studimet e shumta për veprën më të vonë të Wilde-it treguan që shumë fragmente u bëjnë jehonë shkrimeve që ishin thelbësore për rritjen e tij intelektuale. Këto hulumtime nxorën në pah se pjesë të esesë "Kritiku si artist", për shembull, përsërisin ide të "Studime në historinë e Rilindjes" të Pater-it. [24] E njëjta gjë mund të thuhet për shumë pjesë të dialogut ku Lord Henry Wotton flet tek "Portreti i Dorian Grejt". [25] Megjithatë, Wilde rrallë e fshehu ndikimin që pati tek ai "Rilindja" e Pater-it qysh prej "ditëve studentore në Oksford", siç pohoi lirisht në recensionin që i bëri librit studimor "Vlerësime" (1889) të Walter Pater-it:

Esetë e zotit Pater u bënë për mua "libri i artë i shpirtit dhe kuptimit, shkrimi i shenjtë i të bukurës". Të tilla janë për mua edhe sot. Ka mundësi, natyrisht, që po e teproj me këtë që them. Sigurisht shpresoj të jetë kështu, sepse kudo që nuk ka teprim nuk ka dashuri, dhe ku nuk ka dashuri nuk ka mirëkuptim.[26]

Siç nënkuptonte Wilde, të qenit adhurues i flaktë i një shkrimtari tjetër krijoi për të mundësinë për të kuptuar burimin e tij të frymëzimit të parë me sy kritik. Në çdo rast, përdorimet e shpeshta nga Wilde të thënieve të Pateri-it ishte e vështirë t'i ngjanin vjedhjes.[27] Le të marrim në shqyrtim jehonat e shumta të "Rilindjes" së Pater-it që janë të dukshme në romanin e vetëm të Wilde-it. Do ishte e vështirë të pretendoje se mbrojtja që i bën Lord Henri "Hedonizmit të ri", për shembull, vërtetonte synimin e autorit për të vjedhur pa u vënë re nga një burim mëse i njohur. Kështilla që Lord Henri i jep Dorian Grejt për nevojën për të rendur pas kënaqësinë, e cila duket se ngjan me fjalitë në studimin e vitit 1873 "Përfundime" të Pater-it, ka pasoja të tmerrshme. Ato janë krejtësisht të kundërta me këmbënguljen e Pater-it në "dëshirën për të bukurën" si "fryt i vetëdijes së rilindur dhe shumë më të qartë".[28] Pjesët që mund të akuzohen më lehtë për plagjiarizëm, do të ishin fragmente të tëra që perifrazojnë shënime të marra nga katalogët e muzeut të South Kensington-it, apo ato të marra nga një libër francez për qëndisjet dhe dantellat, si dhe informacioni i grumbulluar nga pesë volumet e "Rilindja në Itali" të John Addington Symonds (1875–1886).[29] Këto lista të detajuara të sendeve, instrumenteve, dhe veshjeve fetare që tërheqin vëmendjen e Dorian Grejt, të sjellin ndër mend gjithashtu llojet e *objets d'art* që hasen në romanin anti-realist të J.-K. Huysmans-it me protagonist një koleksionist sendesh me bukuri estetike me titullin "À rebours" (1884), vepër letrare shumë e njohur ku gjenden disa burime të ndryshme franceze prej nga të paktën një lexues i zemëruar bashkëkohës besonte se Wilde i kishte gllabëruar.[30]

Detaje nga ballina e "Gur të çmuar" E A. H. Church, një nga manualet e artit të muzeut të "South Kensington-it prej ku Wilde bëri të vetat listat që përshkruanin objektet e muzeut për t'i përdorur në romanin "Portreti i Dorian Grejt".

Secili prej gurëve në këtë fragment të 'Portreti i Dorian Grejt" është përshkruar me të njëjtët mbiemra që përshkruhen në kreun 7 të librit të librit të A. H. Church "Gurët e çmuar".

Prapëseprapë, këto pretendime të ndryshme për vjedhjen e guximshme të ideve, thënieve dhe situatave janë kundërthënëse me idetë e shtjelluara me kujdes nga Wilde për huamarrjen letrare, çfarë vjedhjeje letrare është e dënueshme dhe shprehjen krijuese. Në rencensat kritike të viteve 1880, Wilde diskutoi për huazimet e pafrymëzuara të cilat nuk shfaqnin integritetin artistik të autorit epo etikën e punës por ishin tregues i shijes së tij të keqe. Kjo do të thotë, shkrimtarët prej të cilëve autori zgjedh të marr dhe shkathtësia me të cilën ai e bën këtë veprim krijojnë premisat e duhura sipas të cilave mund të vlerësohej kjo lloj vjedhje. Analiza e tij në të pëlqyerën "Pall Mall Gazette" për dy vepra poetike nxjerrin në pah këtë dallim: një vëllim me poezi i shkruar gjoja nga "dy endacak", dhe tjetri me autor H. C. Irwin-in. Këtu Wilde mori parasysh lejueshmërinë e huazimit poetik. Duke përdorur gjuhën e shkëputur nga blloku me shënime nga poeti anglez i shekullit të tetëmbëdhjetë Thomas Chatterton (një tekst tjetër që ka ngritur akuza për plagjiarizëm), ai mori "dy endacakët" për t'u ngarkuar detyrën e debatit të ashpër për vjedhjen e papërligjur nga poetët".[31] "Ne ndjejmë", shkroi Wilde, "se të bësh plagjiarizëm është më keq se të vjedhësh pula. "Facilis descensus Averno!"(Sa e lehtë të zbresësh në ferr!), kjo nis me grabitjet në rrugë të madhe dhe krimet e dhunshme dhe pastaj përfundon duke bërë hajdutëri të rëndomta letrare."[32]

Më herët në një recension, Wilde i kishte shfajësuar autorët, madje i kishte lavdëruar, që përpiqeshin "të përvetësonin në fushën e pikturës" nëpërmjet zgjidhjeve estetike të ngjyrës së letrës dhe lidhjes së librit, por ai nënkuptonte se plagjiarizmi ishte akt i rëndë që shkonte përtej kësaj. [33] Një arsye ishte se, megjithëse përvetësimi i ngjyrave nga piktorët ia shtuan bukurinë librit, rreshtat e kopjuara thjesht i bënë poezitë shumë të tmerrshme: si tek ndryshimi me tulipanit me pesë petale dhe tulipanit me tre petale. Ky dallim i theksuar u forcua nga vlerësimi pozitiv i Wilde-it për përmbledhjen poetike të Irwin-it, i cili, sipas fjalëve të tij, "fiton efektin e ngjyrës nga poeti jo nga botuesi" [34] Në poezitë e tij Wilde me siguri gjeti gjurmë të veprave të MathewArnold-it, por ai sidoqoftë e lavdëroi ngaqë "ka mësuar nga poeti i shkëlqyer pa vjedhur gjë prej tij, një gjë shumë e vështirë ta bësh, dhe megjithëse harpa të cilës ai i bie ka njohur të tjerë duar para tij, është në gjendje megjithatë të krijojë një muzikë të re".[35] Me fjalë të tjera, edhe kur merr mësime nga mjeshtri ky ishte rasti kur epigoni i shndërron jehonat e dallueshme të idhullit të tij në art novator. Këtë kuptim thekson kjo ese, shndërrimi dhe përmirësimi i materialit burimor, sipas pikëpamjes së Wilde-it, ishte një qasje e ligjshme ndaj krijimtarisë letrare.

Një nga përfshirjet e fundit, të drejtpërdrejta dhe më mbresëlënëse të Wilde-it në debatin për plagjiarizmin ndodhi me një varg letrash të botuara në "Pall Mall Gazette" me titullin, "Etika e gazetarisë".[36] Ngjarja filloi në 5 gusht, 1894, pas botimit të një poezie të titulluar "Tërfili", në gazetën e Londrës "Weeekly Sun", poezi e cila gabimisht u botua si e Wilde-it. Jo shumë kohë më pas, poezia u botua edhe tek gazeta "New York Sun", ku një lexues i vëmendshëm e njohu poezinë e autores "Helena Calahan" e cila e kishte botuar më parë, dhe i kërkoi shpjegim Oscar Wilde-it me anë të një letre që ia drejtoi gazetës londineze.

Botuesi i "Weekley Sun", T.P.O' Connor (gazetën e të cilit nuk e pëlqente hapur Wilde) u bë shkak që Wilde të kthente përgjigje, e cila erdhi në formën e një letre një muaj më pas tek "Pall Mall Gazette". [37] Wilde vuri në dukje se sa qesharake ishte situata e krijuar. Ai përballej me akuzën e palgjiarizmit nga një botues që kishte botuar një poezi me emrin e tij pa verifikuar autorësinë e saj, dhe për më tepër as nuk kishte kërkuar lejen e autorit (të hamendësuar prej tij) për ta botuar. Wilde e quante poezinë "Tërfili" në mënyrë tallëse si "vargje për kalamaj", të cilat ngrinin dyshime serioze për shijen letrare të autores dhe botuesit përveç çështjes së "etikës së gazetarisë moderne".[38]

Një përgjigje e drejtorit të përgjithshëm të "Weekly Sun" u botua menjëherë në "Pall Mall Gazette". Duke pranuar që në fillim të shkrimit se botuesit "shprehin keqardhjen më të thellë për të nënkuptuarit e një rasti plagjiarizmi", botuesi shpjegoi ndërkohë rrethanat se pse kjo ndodhi: poezia ishte dërguar me postë e shtypur në një letër që pohonte autorësinë e Wilde-it, dhe kjo ishte arsyeja pse "Weekly Sun" e botoi me emrin e tij. Ndoshta për shkak të këtij shpjegimi jo edhe aq bindës, botuesi e përqendroi debatin tek shija letrare, duke mbrojtur "kumbin magjepsës melodik" dhe "patriotizmin e kulluar dhe të madhërishëm" të poezisë duke nënkuptuar se gatishmëria e botuesve për t'ia mveshur poezisë autorësinë e Wilde kishte qenë një gjest bujarie: [39]

Një letër zyrtare e Wilde i dha fund këtij debati. Ai kritikoi "Weekly Sun" se kishte treguar pakujdesi editoriale dhe se nuk kishte kufij të paqartë mes etikës dhe shijes. Nëse botuesit e gazetës vërtetë besonin, argumentonte Wilde-se, ato "vargje të dorës së pestë" ishin të tijat, stafi i gazetës duhej të kishte kërkuar lejen e tij për botim. [40] "Asnjë botues i respektuar" vijonte ai (Wilde kishte qenë botues i një gazete më parë) "nuk e çon ndërmend ta botojë veprën e dikujt pa marrë paraprakisht miratimin e autorit." [41]

Ne mund ta shohim këtë episod si fotografi të çastit e cila na tregon pozicionin e Wilde-it në shtypin e shkruar. Meqenëse ai kishte qenë për një kohë të gjatë shënjestër e akuzave për plagjiarizëm, "Weekly Sun" cënoi në mënyrë të paskrupullt integritetin editorial për të ringjallur edhe një herë tjetër një debat të vjetër publik për inferioritetin e tij artistik. Për më tepër, drejtori i përgjithshëm i botimeve aludonte se ishte origjina e tij irlandeze ajo që duhej të shihej si burimi një inferioriteti të tillë. Është e pazakontë, në gjithë këtë sulm tinëzar, që në letrën e "Weekly Sun" botuar tek "Pall Mall Gazette", në të cilën pranohet gabimi dhe kërkohet ndjesë për akuzat e ngritura për plagjiarizëm, një shënim në fund të letrës shërben si një reklamë e paturpshme për gazetën: "Në numrin tonë të ardhshëm, do të shpërndajmë bashkë me gazetën edhe tekstin e poezisë "Tërfili" të shoqëruar nga një letër të autorit të vërtetë." [42] Një apologji e tillë në shërbim të vetë gazetës, ta krijon deri diku besimin se disa organe të shtypit të shkruar të periudhës së vonë Viktoriane nuk kishin shumë për të humbur kur ndërhynin në polemikat për plagjiarizmin letrar.

The Public Domain Review
(Përkthyer nga Granit Zela)

Takim me autoren franceze Mireille Clapot, për librin e saj "Nga ishulli i Diomedit do ta ngre këtë urë" (Onufri, 2019), Shtëpia e Shqipërisë, Paris, 15.01.2020